



**STRATEGJIA
AFATMESME E TË
ARDHURAVE
2022 - 2026**

Tabela e Përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
HYRJE.....	5
KREU I: NEVOJA PËR HARTIMIN E STRATEGJISË AFATMESME TË TË ARDHURAVE (SAA)	7
TË ARDHURAT E BUXHETIT DHE KONTEKSTI RAJONAL	10
PROBLEMATIKA E IDENTIFIKUAR	12
Administrimi - Informaliteti	12
Politikat tatimore – Përfshirjet dhe tarifat e reduktuara	13
Krahasimi me vendet e rajonit	13
VIZIONI, QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E STRATEGJISË AFATMESME TË TË ARDHURAVE	15
Vizioni i SAA-së	15
Qëllimi i SAA-së	15
Objektivi i SAA-së	15
NDËRVEPRIMI I STRATEGJISË AFATMESME TË TË ARDHURAVE.....	16
DREJTIMIT KRYESORE TË SAA-së	17
KREU II: DIZENJIMI I POLITIKAVE TATIMORE.....	19
Politikat fiskale 2022- 2026.....	19
Tatimet indirekte - Tatimet mbi Konsumin 2022-2026.....	20
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH).....	21
Akciza.....	28
Ndryshimet e synuara në taksat dhe tarifat kombëtare, përfshirë ato ambientale	31
Tatimet Direkte - Tatimet mbi të ardhurat.....	33
Tatimet mbi të ardhurat, fitimin dhe fitimet kapitale për individët dhe personat juridikë.	33
Tatimi mbi fitimin dhe tatimi i thjeshtuar mbi fitimin.....	35
Taksat Lokale.....	41
Taksimi ndërkombëtar	42
Politikat fiskale të synuara sipas viteve të Strategjisë:	44
KREU III: PËRMIRËSIMET NË ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE TATIMORE DHE DOGANORE	45
Administrata Tatimore.....	45
Prioriteti I : Zvogëlimi i hendekut të përmbushjes në TVSH.....	47
Prioriteti II: Reduktimi i punës së padeklaruar dhe nëndeklarimit dhe ekonomisë kesh	52
Prioriteti III: Tatimi i çdo pasurie të pajustificuar brenda dhe jashtë vendit	59
Prioriteti IV: Zvogëlimi i shmangies së taksave.....	63
Prioriteti V. Reduktimi i kostove të përmbushjes, rritja e sigurisë tatimore dhe besimit të administratës tatimore	65
Prioriteti VI. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga AT nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve institucionale të administratës tatimore	69
Administrata Doganore.....	71
Prioriteti VII. Strategjia e përmirësimit të performancës së administrimit doganor	71
Shtojca	79
Shtojca 1 - Ndikimi financiar shprehur në % të PBB-së i Politikave Fiskale të parashikuara gjatë periudhës 2022-2026.....	79
Shtojca 1.1 - Ndikimi financiar shprehur në vlerë i Politikave Fiskale të parashikuara gjatë periudhës 2022-2026	80
Shtojca 2 – Ndikimi financiar shprehur në % të PBB-së i Administrimit Tatimor të parashikuar gjatë periudhës 2022-2026.....	81
Shtojca 2.1 – Ndikimi financiar shprehur në vlerë i Administrimit Tatimor të parashikuar gjatë periudhës 2022-2026	82
Shtojca 3 – Ndikimi financiar shprehur në % të PBB-së i Administrimit Doganor të parashikuar gjatë periudhës 2022-2026	83
Shtojca 3.1 – Ndikimi financiar shprehur në vlerë i Administrimit Doganor të parashikuar gjatë periudhës 2022-2026	84

Lista e Shkurtesave

SAA – STRATEGJIA AFATMESME E TË ARDHURAVE
FMN – FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR
MFE – MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DPD – DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DPT – DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
SKZHI - STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM
PBA – PROJEKT BUXHETI AFATMESËM
PBB – PRODUKTI I BRENDSEHM BRUTO
TVSH – TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR
T-F – TATIM FITIMI
T.TH.F – TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN
AT – ADMINISTRATA TATIMORE
BMP – BORDI I MBIQYRJES PUBLIKE
KKK – KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT
IEKA – INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR
AL – AUDITUESI LIGJOR (AL);
KM – KONTABILISTI I MIRATUAR
ILO – ORGANIZATA BOTËRORE E PUNËS
BE – BASHKIMI EUROPIAN
CEE – VENDET E EUROPËS QENDRORE LINDORE
SEE – VENDET E EUROPËS JUGLINDORE

Lista e Tabelave

Tabela 1 Treguesit fiskal 2005-2021	7
Tabela 2 Tatimpaguesit e regjistruar në skemën e TVSH-së në vitin 2020	26
Tabela 3 Politikat fiskale të parashikuara 2022-2026 dhe efektet e tyre financiare në një vit	43
Tabela 4 Rritja e të ardhurave në përqindje të PBB-së, 2022- 2026	46
Tabela 5 Prioritetit I - Rritja e të ardhurav në % të PBB-së	47
Tabela 6 Të ardhurat shtesë në vlerë nga ndërmarrja e masave të Prioriteti I	48
Tabela 7 Prioritetit II - Rritja e të ardhurav në % të PBB-së	52
Tabela 8 Indikatorët e Prioritetit II	54
Tabela 9 Të ardhurat shtesë në vlerë nga ndërmarrja e masave të Prioriteti II	54
Tabela 10 Të ardhurat shtesë në % të PBB-së të ndara në kategori nga ndërmarrja e masave të Prioriteti II	55
Tabela 11 Indikatorët e Prioritetit IV	64
Tabela 12 Indikatorët e Prioritetit V	66
Tabela 13 Prioritetit VII - Rritja e të ardhurav në % të PBB-së	71
Tabela 14 Masa 1, Prioritetit VII - Rritja e të ardhurav në % të PBB-së	72
Tabela 15 Masa 6, Prioritetit VII - Rritja e të ardhurav në % të PBB-së	74
Tabela 16 Masa 9, Prioritetit VII - Rritja e të ardhurav në % të PBB-së	75
Tabela 17 Masa 10, Prioritetit VII - Rritja e të ardhurav në % të PBB-së	76
Tabela 18 Masa 11, Prioritetit VII - Rritja e të ardhurav në % të PBB-së	76
Tabela 19 Masa 12, Prioritetit VII - Rritja e të ardhurav në % të PBB-së	77
Tabela 20. Ndikimi financiar shprehur në % të PBB-së i Politikave Fiskale të parashikuara gjatë periudhës 2022-2026	79
Tabela 21. Ndikimi financiar shprehur në vlerë i Politikave Fiskale të parashikuara gjatë periudhës 2022-2026	80
Tabela 22. Ndikimi financiar shprehur në % të PBB-së i Administrimit Tatimor të parashikuar gjatë periudhës 2022-2026	81
Tabela 23. Ndikimi financiar shprehur në vlerë i Administrimit Tatimor të parashikuar gjatë periudhës 2022-2026	82
Tabela 24. Ndikimi financiar shprehur në % të PBB-së i Administrimit Doganor të parashikuar gjatë periudhës 2022-2026	83
Tabela 25. Ndikimi financiar shprehur në vlerë i Administrimit Doganor të parashikuar gjatë periudhës 2022-2026	84

Lista e Grafikëve

Grafiku 1: Të ardhurat totale në raport me PBB-në ndër vite	8
Grafiku 2: Përqindja e të ardhurave në raport me PBB-në krahasuar me vendet e rajonit	10
Grafiku 3: Përqindja e tatimeve indirekte krahasuar me vendet e rajonit	20
Grafiku 4: Përqindja e tatimeve direkte krahasuar me vendet e rajonit dhe të BE-së	34

Lista e Figurave

Figure 1 Lidhja e politikave tatimore, administrative dhe kuadrit ligjor	16
Figure 2 Qasjet e politikave dhe masat për zbulimin e punës së padëklaruar	55

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në këtë dokument prezantohet Strategjia Afatmesme e të Ardhurave (SAA) në Republikën e Shqipërisë për vitet 2022-2026, e cila pasqyron reformat në fushën e politikave tatimore dhe administrimit tatimor dhe doganor që parashikohen të ndërmerren gjatë kësaj periudhe pesë vjeçare, me synim përmirësimin e politikave fiskale, rritjen e të ardhurave tatimore dhe efektivitetit të administratës tatimore dhe doganore në mbledhjen e tyre.

Reformat kryesore tatimore dhe administrative të parashikuara në SAA, janë hartuar me asistencën teknike të Fondit Monetar Ndërkombëtar, dhe janë të bazuara në direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e tatimeve, taksave dhe doganave. Reformat e parashikuara kanë në fokus të tyre përmirësimin e politikave tatimore me qëllim rritjen e neutralitetit të sistemit tatimor, eliminimin e deformimeve të krijuara në sistem si dhe përmirësimin e nivelit të tarifave tatimore.

Kjo strategji shërben si një guidë e rëndësishme në vendimarrjen politike në lidhje me politikën fiskale të vendit, si dhe në vendimarrjet e operatorëve ekonomikë në lidhje me strategjitë e biznesit, të cilat kërkojnë qëndrueshmëri në politikën fiskale me qëllim programimin e veprimtarisë dhe aktivitetëve në terma afatgjatë. Strategjia Afatmesme e të Ardhurave, bazuar në reformat e prezantuara, i ofron qeverisë një pasqyrë të qartë të nivelit të të ardhurave tatimore të pritshme në secilin vit të kësaj periudhe 5 vjeçare, sikurse i ofron operatorëve ekonomikë pamje të qartë dhe mbi të gjitha më shumë siguri, mbi mënyrën se si do të trajtohen dhe cilat do të jenë detyrimet tatimore në lidhje me vendimet që do ndërmarrin për investimet e tyre.

Reformat tatimore të propozuara në këtë Strategji 5 vjeçare 2022-2026, parashikohet që në fund të saj, të rrisin të ardhurat tatimore me rreth +2.55% të PBB-së, duke e çuar koeficientin “Të ardhura tatimore/PBB” në 27.75% nga 25.20% që ka rezultuar në vitin 2019. Ndërkohë, totali i të hyrave në buxhet në fund të kësaj periudhe synohet të jetë mbi 30% të PBB-së, nga 27.20% që ka rezultuar në vitin 2019.

Rritja e barrës fiskale (tax burden) me 2.55% të PBB-së së synuar në fund të vitit të pestë, është parashikuar në çdo vit të kësaj Strategjie, duke parashikuar edhe masat/veprimet që do ndërmerren në secilin vit.

HYRJE

Qeveria shqiptare ka miratuar në vitin 2014 dhe ka rishikuar në vitin 2021 Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike. Vizioni i Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike është garantimi i një sistemi të financave publike që nxit transparencën, llogaridhënien, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike, për ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik, ndërkohë që objektivi i përgjithshëm i saj është sigurimi i buxhetit të balancuar dhe të qëndrueshëm, i cili garanton reduktimin gradual dhe të qëndrueshëm të defiçitit buxhetor dhe borxhit publik. Kjo Strategji synon të sigurojë qëndrueshmëri të financave publike shqiptare, duke krijuar baza të forta për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe zhvillim të sektorëve prioritarë.

Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike ka gjithashtu Objektiva Specifike nëpërmjet të cilave synohet:

- të krijohet një kuadër makroekonomik i matur dhe politika fiskale që kanë si objektivi uljen e raportit të borxhit ndaj PBB-së në planin afatmesëm nën 60%, si dhe menaxhimin e risqeve fiskale në mënyrë më efektive;
- të përafrohen më tej dokumentet planifikuese strategjike si: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI II), strategjitë sektoriale dhe Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA);
- të rriten të hyrat e buxhetit, duke përmirësuar dhe forcuar sistemin tatimor dhe duke rritur efikasitetin në mbledhjen e të ardhurave nga tatimet dhe taksat, edhe nëpërmjet uljes së informalitetit.

Qeveria shqiptare ka miratuar gjithashtu edhe Programin e Reformave Ekonomike (ERP), i cili përditësohet çdo vit dhe përfaqëson një dokument që paraqet politikat kryesore makroekonomike dhe fiskale që synojnë të vendosin një ekuilibër të qartë midis forcave të brendshme dhe kërcënimeve të jashtme, me qëllim që të mundësojnë zhvillim të qëndrueshëm, rritje të punësimit dhe uljen e borxhit publik. Bazuar në objektivat e ERP, politika fiskale në periudhën afatmesme do të mbetet e orientuar drejt konsolidimit fiskal në përputhje me rregullat fiskale të përcaktuara në Ligjin Organik të Buxhetit si dhe rekomandimet e dhëna nga KE. Politika fiskale konsoliduese synon të stimulojë trajektoren rënëse të borxhit publik në raport me PBB, i cili u rrit në vitin 2020 dhe arriti në 80% të PBB-së në vitin 2021, për shkak të pasojave të tërmetit dhe pandemisë. Trajektorja rënëse e borxhit publik bruto synohet të ulet në nivelin 73.8% të PBB-së në vitin 2026, dhe kjo ulje do kërkojë rritjen e të ardhurave tatimore në këto vite, ndërkohë që synohet të mbahet nivel i lartë i shpenzimeve në investimet publike, mbështetjen sociale, rritjen e pagave etj.

Edhe në terma afatgjatë, politika fiskale do të vijojë të mbetet qartësisht e orientuar drejt konsolidimit fiskal, duke synuar një ulje të nivelit të borxhit publik bruto për -8.9% të PBB-së deri në vitin 2028, ose me mbi -1.3% të PBB-së mesatarisht në çdo vit, me synimin që në terma kohorë tej vitit 2028, niveli i tij të arrijë objektivin afatgjatë prej 45% të PBB të përcaktuar në rregullat fiskale të ligjit organik të buxhetit.

Realizimi i objektivave dhe synimeve të përcaktuara në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike dhe në Programin e Reformave Ekonomike kërkojnë përmirësime rrënjësore në krahun e të hyrave të buxhetit, dhe kryesisht në mbledhjen e të ardhurave që gjenerohen nga sistemi tatimor, si pikë kyçe për arritjen e realizimit të objektivave strategjike të vendit.

[shqiptarja.com]

KREU I: NEVOJA PËR HARTIMIN E STRATEGJISË AFATMESME TË TË ARDHURAVE (SAA)

Domosdoshmëria për përcaktimin e objektivave afatmesëm të të ardhurave buxhetore, buron nga nevojat për financimin e shpenzime të buxhetit. Sipas skenarit konservativ, projeksionet e shpenzimeve të buxhetit në terma afatmesëm 2022-2026 vlerësohen të jenë mesatarisht çdo vit sa 32% të PBB-së, ndërsa sipas skenarit që merr në konsideratë edhe objektivat e politikave sektoriale të Ministrive të Linjës, nevojat për shpenzime buxhetore vlerësohen të jenë çdo vit nga 35% deri në 45% e PBB-së. Ndërkohë, Qeveria Shqiptare ka përcaktuar se Integrimi Evropian është përparësia kryesore e zhvillimit të vendit dhe synohet që të ulet më tej deficieti fiskal dhe të përshpejtohet ulja e borxhit publik.

Nga analiza e faktorëve, rezulton se nuk ka hapësirë për të arritur objektivat e mësipërm përmes mekanizmit të uljes së shpenzimeve, prandaj janë të domosdoshme masa të forta për rritjen e të ardhurave, përfshirë një sistem më të thjeshtë tatimor, të parashikueshëm nga tatimpaguesit dhe që nuk shtrembëron vendimet e investimeve, zgjerim të konsiderueshem të bazës së taksave, dhe sistem rimbursimi të TVSH-së që funksionon normalisht.

Duke pasur parasysh nevojën për të përmirësuar infrastrukturën dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në Shqipëri, konsolidimi fiskal duhet të mbështetet nga përmirësimet në politikën tatimore dhe administrimin tatimor që çojnë në të ardhura më të larta.


Nëse nevojat për shpenzime buxhetore, sipas skenarit konservativ, do jenë në 5 vitet e ardhshme në nivelin mesatar vjetor 32% e PBB-së, të ardhurat e përgjithshme të buxhetit në vitin 2019 rezultuan në 27,2 % e PBB-së, ndërsa në vitin 2021 do jenë sa 28,1 deri 28,2% e PBB-së. Nëse do të ruajmë politikat ekzistuese në fushën e tatimeve dhe taksave, nuk pritet që të ardhurat e gjeneruara nga sistemi tatimor të kalojnë nivelin e 28,2 % të PBB-së në 4-5 vitet e ardhshme. Pra nëse nuk ndërmerren masa rrënjësore për përmirësimin e politikave fiskale dhe administrimit tatimor, hendeku ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve në buxhet do të jetë problematik dhe do varjojë me diferencë -4% të PBB-së.

TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR
në % të PBB

Nr.	EMËRTIMI	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
		Pritshmi																
	TOTALI TË ARDHURAVE	25.4	26.3	26.1	26.9	26.1	26.2	25.4	24.8	24.2	26.3	26.4	27.6	27.8	27.5	27.2	26.3	28.1
I.	Ndihmat	0.8	0.9	0.1	0.4	0.4	0.4	0.3	0.4	0.4	0.7	0.8	1.0	0.7	0.5	0.6	0.5	1.0
II.	Të ardhura tatimore	22.9	23.5	23.6	24.5	23.7	23.3	23.4	22.6	22.2	24.1	23.9	25.1	25.7	25.6	25.2	24.6	25.9
II.1	Nga tatimet dhe doganat	16.9	17.8	18.3	19.0	18.3	18.0	18.1	17.5	17.0	18.2	18.0	18.7	18.9	18.6	18.0	17.2	18.5
	Tatimi mbivlerën e shtuar	8.0	8.5	9.1	9.9	9.6	9.2	9.2	8.7	8.3	8.9	8.8	8.9	9.0	8.8	7.8	8.1	18.5
	nga Tatimet	2.5	2.6	2.5	3.0	2.9	2.4	2.0	1.9	1.8	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	nga Doganat	5.6	5.9	6.6	6.9	6.8	6.8	7.1	6.9	6.5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Tatimi mbi fitimin	2.4	2.6	2.2	1.7	1.5	1.4	1.5	1.3	1.1	2.1	1.7	2.0	2.0	2.1	2.2	1.8	0.0
	Akcizat	2.3	2.6	3.0	3.0	2.9	3.1	3.1	2.7	2.8	2.3	2.7	2.8	2.9	2.7	2.8	2.8	0.0
	nga Tatimet	0.9	1.0	1.0	1.1	1.2	1.1	1.2	0.9	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	nga Doganat	1.4	1.7	2.0	1.9	1.8	2.0	1.9	1.8	2.8	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Tatimi mbi të ardhurat personale	0.9	1.0	1.5	2.3	2.3	2.2	2.2	2.1	2.2	1.5	2.1	2.1	2.1	2.2	2.7	2.1	0.0
	Taksa nacionale dhe të tjera	1.5	1.5	1.5	1.3	1.2	1.5	1.6	2.2	2.1	2.9	2.3	2.4	2.5	2.4	2.2	2.2	0.0
	nga Tatimet	1.5	1.5	1.5	1.3	1.1	1.3	1.4	1.7	1.5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	nga Doganat	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.3	0.4	0.6	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Taksa doganore	1.7	1.6	1.0	0.8	0.7	0.6	0.5	0.5	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.0
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	1.5	1.3	1.0	1.0	1.1	1.0	0.9	0.8	0.8	0.9	0.8	1.0	1.2	1.3	1.4	1.4	1.5
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	4.5	4.5	4.3	4.4	4.4	4.3	4.4	4.3	4.4	5.0	5.0	5.4	5.6	5.7	5.8	6.0	5.9
III.	Të ardhura jo-tatimore	1.8	1.8	2.3	2.1	2.1	2.5	1.7	1.8	1.6	1.5	1.8	1.5	1.3	1.4	1.4	1.2	1.2

Tabela 1 Treguesit fiskal 2005-2021

Të ardhurat totale të buxhetit të shtetit në raport me PBB-në të vlerësuara në % (2005-2021).



Grafiku 1: Të ardhurat totale në raport me PBB-në ndër vite

Te ardhurat totale të buxhetit të shtetit për periudhën 2009-2013 kanë qënë mesatarisht 25,3% e PBB-së në vit, ndërsa për periudhën 2014-2020 janë sa 27,1% e PBB-së në vit. Në vitin 2013, të ardhurat totale të buxheti u ulën në 24,2% e PBB-së, ndërkohë që vetëm të ardhurat tatimore rezultuan në 22,2% e PBB-së, niveli më i ulët prej vitit 2003.

Për shkak të rënies së të ardhurave të buxhetit të shtetit, dhe sidomos e të ardhurave tatimore, Qeveria e re, e përzgjedhur nga zgjedhjet e vitit 2013, ndërmori reforma dhe ndryshime të rëndësishme me qëllim rritjen e të ardhurave, reduktimin e defiçitit buxhetor, pagesën e detyrimeve të prapambetura dhe uljen graduale të borxhit publik. Reforma në fushën e të ardhurave konsistoi kryesisht në:

- zëvendësimin e taksimit të sheshtë 10% me taksimin progresiv 0%, 13% dhe 23% mbi të ardhurat nga punësimi;
- rritjen e normës së tatimit mbi fitimin korporativ nga 10% në 15%;
- rritjen e tarifës së tatimit nga 10% në 15% për kategoritë e tjera të të ardhurave personale;
- rritjen e ngarkesës fiskale për mallrat e akcizës.

Ndryshimet në politikat e taksave ndihmuan në rritjen e të ardhurave nga taksat, të cilat në vitin 2017 arritën në 25,7% e PBB-së nga 22,2% e PBB-së në vitin 2013, para politikave të reja fiskale.

Pas vitit 2017, qeveria ndërmori një sërë masash lehtësuese në politikat fiskale, përfshirë:

- zero tatim për bizneset e vogla me të ardhura deri 5 milion lekë në vit;
- tarifë të reduktuar tatimi 5% për sipërmarrjet me të ardhura deri 14 milion lekë;
- tarifa të reduktuara preferenciale për sektorë dhe industri prioritare në zhvillimin e vendit si turizmi elitare, agroturizmi, teknologjia e informacionit, industria automotive;

- përjashtimin nga TVSH të inputeve dhe makinerive bujqësore, apo importeve të tjera në funksion të zhvillimit të turizmit.

Masat e marra për lehtësimin e barrës fiskale, të shoqëruara edhe me (i) uljen e ritmit të rritjes ekonomike si rezultat i përfundimit të investimeve madhore të tilla si TAP apo Devolli Hydro Power, (ii) efekteve negative në ekonomi të situatës energjitike për shkak të thatësisë dhe (iii) pasojave të fatkeqësisë natyrore për shkak të tërmetit dhe pandemisë, kanë rezultuar në ulje të të ardhurave të buxhetit të shtetit dhe veçanërisht të të ardhurave tatimore që gjenerohen nga sistemi tatimor, të cilat në fund të vitit 2020 rezultuan në 24,6 % të PBB-së, ose -0,6% të PBB-së më pak se në vitin 2019.

Gjatë vitit 2020 një sërë aktesh ligjore janë ndërmarrë me qëllim zbutjen e efekteve financiare të shkaktuara nga pandemia mbi veprimtarinë e bizneseve dhe të ardhurave individuale. Në këtë kuadër u ndërmor edhe ndryshimi në shkallën tatimore të aplikuar për tatim fitimin.

Duke filluar nga 1 janari 2021:

- a) shkalla tatimore për tatimin mbi fitimin dhe tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e bizneseve të vogla, për tatimpaguesit me qarkullim, deri në 14 milion lekë në vit, bëhet 0%. Me anë të kësaj incentive, tatimpaguesve me qarkullim nga 5-14 milionë lekë u lehtësohet barra fiskale në kuadër të tatimit mbi fitimin dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, ku nga 5% tatim që paguanin më parë, (rreth 0.8 miliard lekë gjatë vitit 2019), nga 1 janari 2021 nuk paguajnë tatim mbi të ardhurat nga biznesi;
- b) pragu minimal i regjistrimit në tatimin mbi vlerën e shtuar u rrit nga 2 milion lekë qarkullim në një vit kalendarik, në 10 milion lekë. Ulja e pragut të regjistrimit për TVSH-në u miratua në kuadër të politikave fiskale të ndërmarra në mbështetje të krijimit të një kuadri ligjor mbështetës për tatimpaguesit që u përballën me vështirësi të mëdha dhe të tejzgjatura nga situata e krijuar nga pandemia COVID-19. Kontributi në TVSH i tatimpaguesve që për shkak të rritjes së pragut të regjistrimit dolën nga skema e TVSH-së llogaritej në rreth 3-4% të totalit të TVSH-së së arkëtuar.

Në vitet e fundit janë realizuar ndryshime të shumta dhe të shpeshta të legjislacionit tatimor, përfshirë tarifatat e tatimit dhe përjashtimet tatimore. Ndryshimet e shpeshta nuk kanë stimuluar qëndrueshmërinë e sistemit tatimor dhe kanë ndikuar edhe në uljen e performancës në mbledhjen e të ardhurave, por njëkohësisht kanë çuar në rritjen e kostove të administrimit nga administrata fiskale, por edhe të kostove të pajtimit të tatimpaguesve. Ndonëse të ardhurat gjatë viteve të fundit kanë trend rritës, vihet re që rritja e të ardhurave rezulton me ritme rënëse. Nga ana tjetër objektivat për rritjen e shpenzimeve me rreth 2.00% – 2.55% të PBB-së, të nevojshme këto për stimulimin e zhvillimit ekonomik të vendit, kërkojnë rritjen e të hyrave buxhetore me ritme më të shpejta ku më e rëndësishme është rritja e të ardhurave tatimore.

Në këtë kuadër lind nevoja e kalimit në fazë reformimi të sistemit tatimor, në harmoni me praktikatat më të mira ndërkombëtare, reformë e cila do të ndikojnë në rritjen e të ardhurave tatimore dhe në vijimësinë e zbatimit të reformave të rëndësishme strukturore që Shqipëria ka ndërmarrë në mbështetje të konsolidimit të financave publike, përmirësimin e qeverisjes dhe


ofrimin e shërbimeve publike cilësore, mbështetjen e rritjes së produktivitetit dhe konkurrencës në ekonomi, krijimin e vendeve të reja të punës, etj.

Pra, ritmet jo të duhura në rritjen e ardhurave të buxhetit për shkak të faktorëve të përmendur më lart, ndërkohë që Ministria e Financave dhe Ekonomisë përballlet me rritje të presionit për më shumë shpenzime për shkak të nevojave dhe kërkesave në rritje për investime, rritje pagash, pensionesh dhe mbështetje sociale, bëjnë të domosdoshme ndërmarrjen e reformave të thella me qëllim rritjen dhe konsolidimin e të ardhurave të buxhetit, nëpërmjet të cilave do të bëhet i mundur financimi i shpenzimeve dhe mbajtja nën kontroll e deficitit buxhetor.

TË ARDHURAT E BUXHETIT DHE KONTEKSTI RAJONAL

Nisur nga pesha që zenë të ardhurat e buxhetit në raport me PBB-në dhe veçanërisht të ardhurat që gjenerohen nga sistemi i tatimeve, taksave dhe kontributeve të detyrueshme, e kombinuar kjo me nivelin e tarifave tatimore, përjashtimeve dhe incentivave sektoriale, rezultojnë se Shqipëria ka hapësirë për të rritur të ardhurat e buxhetit, të cilat duhet të derivojnë si nga ndryshimet e domosdoshme në politikat fiskale, ashtu edhe nga përmirësimet në administrimin e të ardhurave nga tatimet dhe taksat.

Tabela e mëposhtme tregon pozicionin e Shqipërisë krahasuar me vendet e tjera në lidhje me raportin në përqindje të të ardhurave nga taksat/PBB-së.



Grafiku 2: Përqindja e të ardhurave në raport me PBB-në krahasuar me vendet e rajonit

CEE (EU) përfshin vendet antare të BE-së nga Europa qendrore dhe lindore (Ceki, Hungari, Poloni, Sllovakia, Slloveni).

SEE (EU) përfshin vendet antare të BE-së nga Europa juglindore (Rumani, Bullgari dhe Kroaci).

SEE (non EU) përfshin vendet e Europës juglindore që nuk janë antare të BE (Serbia, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Bosnja dhe Hercegovina).

Sikurse shihet nga grafiku, të ardhurat tatimore në raport me PBB-në e vendit tonë krahasuar me vendet e tjera, në 10 vitet e fundit janë minimalisht më të ulta me rreth 5% e PBB-së.

Me qëllim adresimin e problematikës me të ardhurat e buxhetit dhe sigurimin në terma afatmesme të burimeve për financimin e shpenzimeve buxhetore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë inicioi hartimin e një strategjie afatmesme të të ardhurave të buxhetit. Për këtë qëllim u ftua Departamenti i Çështjeve Fiskale në FMN për të dhënë ekspertizën e kualifikuar në drejtim të rishikimit të politikës së taksave dhe përmirësimeve në administrimin tatimor dhe doganor. Në korrik 2019, me Urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë u krijua Komiteti Drejtues me përfaqësues nga Ministria dhe Administratat tatimore dhe doganore, me qëllim sigurimin e bashkëpunimit me ekspertët e FMN-së dhe analizimin e situatës së brendshme lidhur me këtë strategji. Në muajin nëntor 2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë mirëpriti dy misione të Departamentit të Çështjeve Fiskale në FMN, të cilët analizuan situatën dhe asistuan stafet lokale për zhvillimin e kapaciteteve në hartimin e kësaj Strategjie. Misionet e FMN-së analizuan dhe përpunuan gjërësisht të dhënat, zhvilluan takime intensive me të gjitha institucionet relevante, si dhe me Ministrin e Financave dhe Ekonomisë. U analizuan politikat fiskale aktuale, problematikat e shfaqura në administrimin tatimor, mbi bazën e të cilave u dhanë rekomandime për masat që është e nevojshme dhe që duhet të ndërmeren sipas afateve përkatëse. Raportet dhe rekomandimet e asistencës teknike të FMN-së, kanë shërbyer si bazë për hartimin e draftit fillestar të Strategjisë Afatmesme të të ardhurave.

Duke marrë në konsideratë situatën e post tërmetit të 26 nëntor 2019 si dhe pasojat e zgjatura negative në ekonomi si shkak i pandemisë Covid-19, Ministria e Financave dhe Ekonomisë rishikoi dhe rianalizoi objektivat e saj për Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave. Për këtë qëllim, u ftua përsëri Departamenti i Çështjeve Fiskale në FMN, në mënyrë që të diskutohej dhe analizohej Draft-Strategjia e hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, por duke marrë në konsideratë periudhën 2020-2021, periudhë kur ekonomia e vendit dhe financat publike u përballën me pasojat e tërmetit dhe pandemisë. Për shkak të këtyre faktorëve dhe situatës së krijuar, ishte i domosdoshëm rishikimi i afateve dhe objektivave vjetorë të parashikuar në draft-strategjinë e hartuar në fund të vitit 2019, duke marrë në konsideratë një periudhë të nevojshme rikuperimi të ekonomisë dhe situatës ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë dhe sipërmarrjeve.

Nëpërmjet masave dhe ndryshimeve të parashikuara në politikat dhe administrimin tatimor, Strategjia afatmesme e të ardhurave (SAA) synon rritjen e të ardhurave të buxhetit me rreth 2.55% të PBB-së për një periudhë pesë vjeçare 2022-2026, nga të cilat 1.31% do gjenerohen nga ndryshimet në politikat tatimore dhe 1.24% e PBB-së nga përmirësimi i elementeve të administrimit tatimor dhe doganor.

Sikurse theksuam, duke marrë në konsideratë efektet dhe pasojat e shkaktuara në ekonomi dhe në financat publike të vendit nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, si dhe nga pandemia globale e Covid -19, Ministria e Financave dhe Ekonomisë rianalizoi dhe rishikoi objektivat dhe afatet e dizenuara për ndryshimin e politikave tatimore, me qëllim tejkalimin së pari të problematikës

së efekteve negative që krijuan për ekonominë e vendit, për operatorët ekonomikë dhe financat publike këta faktorë të paparashikuar dhe këto ngjarje të jashtëzakonshme. Ridizenjimi i objektivave synoi kryesisht:

- dhënien fillimisht të stimujve fiskale me qëllim tejkalimin e situatës së vështirë ekonomike dhe financiare që pritej të kalonin bizneset, kryesisht ato të vogla dhe të mesme sidomos në vitin 2020;
- shtyrjen në kohë të implementimit të masave të parashikuara në politikat fiskale, duke i dhënë mundësi ekonomisë së vendit dhe sipërmarrjes në vitet 2020 dhe 2021, që fillimisht të rikuperojnë pasojat e tërmetit dhe pandemisë. Ridizenjimi i Strategjisë dhe shtyrja në kohë e aplikimit të masave fiskale u diskutua edhe me ekipin e Departamentit të Çështjeve Fiskale të FMN-së.

PROBLEMATIKA E IDENTIFIKUAR

Administrimi - Informaliteti

Pavarësisht përpjekjeve që janë bërë ndër vite për formalizmin e ekonomisë, ende Shqipëria ka probleme të nënraportimit, informalitetit dhe evazionit fiskal.

Anketimet e bëra nga Këshilli i Investimeve mbi klimën e biznesit në vend me rreth 3 mijë biznese, në janar 2020, treguan një rritje të perceptimit mbi ekzistencën e konkurrencës informale krahasuar me një vit më parë. Perceptimi më i lartë i informalitetit është për sektorin e shërbimeve, ndërtimin, bizneset me qarkullim pranë pragut të TVSH-së (10 milionë lekë) dhe bizneset me të ardhura pranë pragut përjashtues të tatimit mbi fitimin (14 milionë lekë). *Korrupsioni, konkurrenca e pandershme dhe barra fiskale e deformuar* në nivel qendror, janë identifikuar si faktorët kryesorë që nxisin informalitetin sipas perceptimit të biznesit edhe gjatë vitit 2019, ndërkohë që kompleksiteti i legjislacionit tatimor dhe taksat lokale janë faktorë më pak të rëndësishëm. Natyra e informalitetit, sipas shkallës së rëndësisë është: nënraportim me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore, puna në të zezë, korrupsioni, mosregjistrimi dhe mosdeklarimi i veprimtarisë. Bujqësia ka informalitet të natyrës së mosregjistrimit ndërsa sektorët e tjerë e konsiderojnë informalitetin të natyrës së mosraportimit/nënraportimit dhe shmangies së detyrimeve tatimore. Për biznesin me xhiro deri në 8 milionë lekë mendohet se natyra e informalitetit lidhet përgjithësisht me shmangie taksash dhe punën në të zezë, ku vazhdon i njëjti trend në vite. Për biznesin me xhiro mbi 8 milionë lekë natyra e informalitetit lidhet me shmangien e taksave dhe korrupsionin.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020, Administratat fiskale ndërmorën Planin Operacional të luftës ndaj informalitetit i cili tregoi për një nivel të lartë evazioni. Strukturat e hetimit tatimor kreu rreth 12,728 kontrolle, ndërsa u konstatuan 2,482 shkelje të legjislacionit tatimor, pra, 20% e kontrolleve të kryera janë konstatuar me shkelje. U kontrolluan rreth 3,334 njësi që operojnë në sektorin e turizmit, nga të cilat u konstatuan 584 me shkelje të legjislacionit tatimor, pra 18% e kontrolleve të kryera janë konstatuar me shkelje.

Inspektoriati Shtetëror i Punës kreu kontrole në rreth 6,096 subjekte, nga të cilët në 1,213 subjekte ose 20% të totalit u konstatua punësim informal. Në 36% të subjekteve të kontrolluara u konstatua shkelje e dispozitave ligjore të legjislacionit të punës.

Informaliteti është një fenomen i krijuar në një periudhë 30 vjeçare në të cilin ka pasur një ndërveprim midis bizneseve dhe strukturave të administratave tatimore e doganore, të cilat për mungesë kapacitetesh e vullneti kanë lejuar ndër vite informalitet/evazion/nënraportim. Pikërisht për këtë arsye të ardhurat tatimore në përqindje të PBB-së në Shqipëri janë ndër më të ultat në krahasim edhe me vendet e Rajonit.

Politikat tatimore – Përrjashtimet dhe tarifat e reduktuara

Raporti i “Shpenzimeve Tatimore 2019-2020” tregon se vlera e të ardhurave të munguara si rezultat i evazionit, përjashtimeve, aplikimit të normave të reduktuara, të quajtura ndryshe “shpenzime tatimore”, për vitin 2019 llogaritet rreth 84.4 miliardë lekë ose 5.0 % e Produktit të Brendshëm Bruto të vendit. Rreth 95,9% e “shpenzimeve tatimore” rrjedhin nga evazoni, përjashtimet dhe aplikimi i normave të reduktuara të TVSH-së. Ky rezultat është i pritshëm pasi të ardhurat nga TVSH-ja zënë peshën kryesore në portofolin e të ardhurave tatimore. Shpenzimet tatimore që krijohen nga përjashtimet apo aplikimet e normave të reduktuara në tatimet e tjera, si Akcizë, Tatimi mbi të ardhurat, Tatimi mbi fitimin korporativ, variojnë nga 1%–2% të PBB-së. Brenda vlerës së llogaritur të shpenzimeve tatimore përfshihet informaliteti ose të ardhurat e munguara si pasojë e evazionit. Nëse me tatim mbi vlerën e shtuar me normën standarde, do të ngarkohej cdo mall ose shërbim, të ardhurat teorike nga TVSH-ja do ishin 273 miliard lekë. Në fakt janë arkëtuar 132,4 miliard lekë, ose 48,5 % e shumës teorike. Diferenca 140,6 miliard lekë që nuk arkëtohet i takon:

- (i) 80,9 miliard lekë “shpenzimeve tatimore” pra përjashtimeve nga TVSH apo tarifave të reduktuara të TVSH-së, kufirit të TVSH-së, prodhimit vetjak të cilat janë të miratuara në ligj, dhe,
- (ii) 51,5 miliard lekë konsiderohen “compliance gap” ose TVSH e humbur për shkak të nënraportimit/informalitetit/evazionit.

Ndërkohë, rezultatet për vitin 2020 të prezantuara në raportin “Shpenzimet tatimore 2019-2020” vazhdojnë të ruajnë të njëjtin trend si ato të vitit 2019, ku në total, për të gjitha tatimet e analizuara, vlera e shpenzimeve tatimore, për vitin 2020 llogaritet rreth 86.8 miliardë lekë (nga 84,4 miliardë lekë në vitin 2019) ose 5.4% e PBB-së. Ndërkohë, shpenzimi tatimor për çdo lloj tatimi ruan përgjithësisht të njëjtën peshë specifike si në vitin 2019. Shpenzimi tatimor i TVSH-së është rreth 5.2% e PBB-së, ndërsa tatimet e tjera janë rreth 0.2% e PBB-së.

Krahasimi me vendet e rajonit

Për të kuptuar më qartësisht pozicionin e Shqipërisë në lidhje me barrën e taksave dhe sistemin tatimor në përgjithësi, është e nevojshme që kuadri fiskal i vendit të krahasohet me vendet e tjera të rajonit. Përgjithësisht, Shqipëria ka disa karakteristika ekonomike, tipare të taksimit

dhe elementë ligjorë, të cilat janë të ngjashme me vendet e rajonit të Ballkanit perëndimor, por edhe me disa nga vendet e Europës Qendrore dhe Lindore. Nëse analizojmë ndarjen në: tatime mbi konsumin (tatime indirekte) dhe tatime mbi të ardhurat (tatimet direkte), dallimet dhe ngjashmëritë në kontekstin rajonal bëhen edhe më të qarta. Më poshtë listohen disa nga çështjet kryesore, të cilat janë konstatuar dhe analizuar edhe nga Asistenca Teknike e Fondit Monetar Ndërkombëtar në Nëntor të vitit 2019 dhe Tetor të vitit 2021.

- Krahasuar me vendet e rajonit, **Shqipëria është e renditur më poshtë në përqindjen e mbledhjes së të ardhurave në raport me PBB-në sesa mesatarja e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore** (pjesë e BE-së) dhe vendeve të tjera të Ballkanit që nuk janë pjesë e Bashkimit Europian. Nëpërmjet kësaj Strategjie, synohet që, në vitet në vijim, Shqipëria të përmirësojë dhe harmonizojë raportin “Të ardhura tatimore/PBB-së” me mesataren e këtyre vendeve.
- Shqipëria ngjason me vendet e rajonit për sa i takon mbledhjes së të ardhurave, sidomos të të ardhurave tatimore. Këto të ardhura, së bashku me të ardhurat e mbledhura nga kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore përbëjnë bazën kryesore të të ardhurave për thujtë të gjitha shtetet e rajonit të Ballkanit, Europës Qendrore dhe asaj Lindore. Nëse për të ardhurat tatimore Shqipëria qëndron jo shumë larg niveleve mesatare të rajonit (sidomos Ballkanit Perëndimor), për të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, **Shqipëria mbledh thujtë gjysmën e të ardhurave që mbledhin shtetet e rajonit**. Veçojmë gjithashtu që, pesha kryesore në të ardhurat tatimore mbahet nga tatimet indirekte, të cilat zënë thujtë 67% të të gjithë të ardhurave tatimore që mbliidhen dhe ku Shqipëria aplikon normë standarde të TVSH-së (20 %) më të lartë se disa vende të rajonit.
- Shqipëria ka një raport të koeficientit C të efikasitetit të TVSH-së relativisht të ulët. Ky koeficient në **Shqipëri llogaritet të jetë 0.54, çka do të thotë se mbliidhen 54% e të ardhurave potenciale nga TVSH-ja me normën standarde**. Edhe pse Shqipëria ka një normë standarde (20%) ndër më të lartat krahasuar me fqinjët ballkanikë jo anëtarë të BE-së, ky raport mbetet më i vogël se vende si Serbia, Mali i Zi, Bosnje-Hercegovina apo Maqedonia e Veriut. Për t’u analizuar mbeten faktorët strukturorë të TVSH-së, si dhe mënyra e funksionimit të skemës dhe zinxhirit të TVSH-së në vend.
- Të ardhurat nga tatimi direkt i të ardhurave personale dhe kontributet mbeten sidoqoftë një nga burimet më të rëndësishme të të ardhurave për Shqipërinë. Të dhënat ndër vite tregojnë që niveli i të ardhurave që mbliidhet nga këto burime i korrespondon mesatarisht nivelit 16% të PBB-së.
- Krahasuar me vendet e rajonit, Shqipëria ka një nga skemat më progresive të tatimit mbi të ardhurat. Megjithatë, ky progresivitet i tatimit mbi të ardhurat në disa momente ka krijuar një incentivë të gabuar në lidhje me favorizimin e trajtimit të të vetëpunësuarve jashtë skemës së tatimit mbi të ardhurat personale nga puna.

VIZIONI, QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E STRATEGJISË AFATMESME TË TË ARDHURAVE

Për forcimin dhe rritjen e përqindjes së të ardhurave që mblidhen në raport me PBB-në, nevojitet hartimi i një Strategjie Afatmesme të Ardhurash, e cila do të shërbejë si pika kyçe e orientimit të vendimmarjes në lidhje me të ardhurat publike. Kjo strategji përmbledh në mënyrë vizionare objektivin kryesor mbi rritjen e qëndrueshme të të ardhurave tatimore në raport me PBB-në, si dhe rrugën sesi do arrihet drejt këtij objekti.

Vizioni i SAA-së

SAA mbështetet në vizionin se politikat fiskale të mirë dizenuara luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Kjo Strategji mbështetet gjithashtu në vizionin që ka Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zhvillimin e një sistemi të të ardhurave buxhetore eficient, të thjeshtë, transparent, të qëndrueshëm, të aftë për të suportuar ofrimin e shërbimeve të përmirësuara ndaj publikut dhe rritjen ekonomike, si dhe forcimin e stabilitetit të financave publike të vendit.

Ky vizion synon të gjenerojë të ardhura të qëndrueshme për buxhetin, përmes një sistemi tatimor efektiv, të drejtë dhe neutral.

Qëllimi i SAA-së

Qëllimi i SAA-së është mobilizimi i të ardhurave përmes politikave të qëndrueshme fiskale, dhe reformave administrative, duke thjeshtuar procedurat, me qëllim krijimin e hapësirave fiskale për investime dhe zhvillimi të qëndrueshëm, përfshirë shëndetësinë, arsimin, mbrojtjen sociale dhe infrastrukturën.

SAA është një udhërrëfyes i nivelit të lartë të vendimmarrjes për reformimin e sistemit fiskal për një periudhë afatmesme, të nevojshme për të ndihmuar në financimin e objektivave strategjikë të qeverisë.

Objekti i SAA-së

Objekti i strategjisë afatmesme të të ardhurave është rritja e qëndrueshme në nivelin deri +2.55% të përqindjes së mbledhjes së të ardhurave në raport me Produktin e Brendshëm Bruto, nga të cilat 1.31% pritet të gjenerohen si rezultat i masave që do të ndërmerren në fushën e ndryshimeve të politikave fiskale dhe 1.24% nga reformat e ndërmarra në fushën e administrimit tatimor/doganor dhe investimeve në teknologji. Ministria e Financave dhe Ekonomisë së bashku me administratën tatimore dhe atë doganore, synojnë përmbushjen e këtij objekti në Reformim e sistemit tatimor në periudhën afatmesme 2022–2026.

Shtyllat themelore mbi të cilat mbështetet kjo Strategji, me synim realizimin e vizionit, qëllimit dhe objektivave, janë:

- Përcaktim i qartë i objektivave sasiorë dhe synimeve që duhet të arrihen nëpërmjet SAA-së;

- Reformë tërësore e politikave tatimore, dhe kuadrit përkatës ligjor për të arritur objektivat e të ardhurave;
- Konsensus i gjerë politik për objektivat afatmesme në lidhje me të ardhurat që nevojiten për financimin e shpenzimeve publike të dakordësuara; si dhe
- Koordinim i kapaciteteve dhe mbështetje e bashkërenduar, përfshirë financime dhe suport për zhvillimin e kapaciteteve administrative për zbatimin e SAA-s.

SAA-ja bashkon këto katër komponentë për të trajtuar boshllëqet e identifikuara përmes procesit të analizës së hendekut tatimor. Pikërisht qasja kryesore në këtë strategji, bazohet në ndërthurjen e këtyre 4 komponentëve të lartpërmendur. Në përgjithësi, vizioni do të arrihet duke forcuar politikat tatimore, përmbushjen dhe kapacitetet administrative drejt sistemeve efektive dhe të fuqishme të të ardhurave.

NDËRVEPRIMI I STRATEGJISË AFATMESME TË TË ARDHURAVE

SAA-ja trajton komponentët e politikave fiskale, ato administrative dhe ligjore të sistemit tatimor dhe doganor në një mënyrë tërësore dhe interaktive. Ajo ofron bashkërendim thelbësor midis këtyre tre elementëve të sistemit fiskal, si më poshtë:




Figure 1 Lidhja e politikave tatimore, administrative dhe kuadrit ligjor

Kjo qasje është thelbësore për menaxhimin e sfidave të mbledhjes së të ardhurave, nëpërmjet krijimit të një sistemi tatimor të qëndrueshëm, që përputhet me mjedisin e ndryshueshëm ekonomik dhe praktikat në zhvillim të biznesit. Ndërvarësia dhe lidhjet midis elementëve të ndryshëm të sistemit tatimor, krijojnë një mjedis biznesi, investimesh dhe pagese taksash, i cili përmban politika të qarta për të mbështetur arritjen e objektivave të qëndrueshme të zhvillimit, dhe që inkurajon investimet.

DREJTIMET KRYESORE TË SAA-së

Si një nga mekanizmat bazë të mbledhjes së të ardhurave publike për buxhetin e shtetit, politikat fiskale ndikojnë në mënyrë direkte në rritjen ose uljen e këtyre të ardhurave. Me anë të ndryshimeve ligjore në këto politika, bëhet i mundur krijimi i kornizave brenda së cilës ndërtohen parashikimet dhe projeksionet e të ardhurave tatimore dhe doganore, si dhe matja e efekteve që sjell çdo ndryshim në politikat fiskale. Nëse i referohemi legjislacionit shqiptar, përgjatë 3 dekadave të fundit, vihen re ndryshime të shpeshta në ligjet fiskale. Këto ndryshime përgjithësisht kanë pasur si objektiv përafrimin me kuadrin ligjor të Bashkimit Evropian (BE) dhe përputhjen e tyre me direktivat që përmbajnë këto ligje. Në disa raste, ndryshimet fiskale kanë synuar të nxisin sektorë ose degë të veçanta të ekonomisë. Në raste të tjera, disa ndryshime lidhen me përshtatjen ndaj një situatë emergjente, specifike ose me karakteristika unike, si për shembull fatkeqësia natyrore pas tërmetit të 26 nëntorit 2019 apo emergjenca si rezultat i pandemisë globale të COVID-19.

Si një ekonomi relativisht e vogël krahasuar me vendet e BE-së, një nga faktorët për të cilët ekonomia shqiptare ka më shumë nevojë lidhet me konsolidimin fiskal. Ndryshimet e shpeshta ligjore mund të sjellin një situatë jo të favorshme për klimën e biznesit, investimet e huaja direkte, etj. Në këtë kontekst, konsolidimi fiskal gjykohej të jetë një faktor kyç për disa arsye:

- Konsolidimi fiskal krijon një qëndrueshmëri më të lartë në ecurinë e biznesit dhe klimën ekonomike në vend. Një tatim që nuk ka pësuar shumë ndryshime dhe është i thjeshtë për t'u paguar nga qytetarët ose bizneset, priret të sjellë të ardhura më të larta. Kjo në mbështetje edhe të parimit që *“një tatim i vjetër është një tatim i mirë”*.
- Një kuadër ligjor i konsoliduar, si pasojë e qëndrueshmërisë së ligjeve fiskale, sjell nxitjen dhe incentivimin e investimeve të huaja direkte. Duke mos pasur ndryshime të herëpashërëshme të normave tatimore, përjashtimeve, zbritjeve apo shkallëve të reduktuara, një investitor e ka më të lehtë të analizojë sektorin ku duhet të investojë.
- Konsolidimi fiskal rrit pashmangshmërisht të ardhurat. Duke pasur një kuadër ligjor solid dhe një administratë fiskale të konsoliduar, rritja e të ardhurave vjen gradualisht e shoqëruar edhe me uljen e evazionit dhe mosraportimit. Një administratë tatimore e fuqishme nuk mund të kuptohet pa qenë e konsoliduar.

Konsolidimi fiskal është i rëndësishëm sidomos kur bëhet fjalë për administrimin e të ardhurave tatimore. Aktualisht, administrata doganore ka një sistem raportimi dhe administrimi në kohë reale. Projekti i Fiskalizimit, nëpërmjet faturës elektronike, synon të krijojë një sistem të tillë edhe administratës tatimore. Megjithatë, në terma afatgjatë, të dyja administratat që mbledhin tatime/taksa, do të kenë në fokusin e punës së tyre konsolidimin, me qëllim rritjen e të ardhurave brenda potencialeve të sistemit fiskal shqiptar.

Vendit tonë i nevojitet një sistem i fuqishëm dhe modern i të ardhurave, që të gjenerojë një nivel më të lartë dhe të qëndrueshëm të tyre. Reformat synojnë keto drejtime kryesore:

- Përmirësimin e konkurrencës dhe efikasitetin e sistemit tatimor, me qëllim tërheqjen e kapitalit për të ndihmuar në zgjerimin, ruajtjen dhe inkurajimin e investimeve, punësimit dhe zhvillimit ekonomik;

- Garancitë që sistemi tatimor të mishërojë parimet e një sistemi efektiv tatimor;
- Sigurimin që sistemi tatimor është i balancuar në mënyrën e duhur ndërmjet tatimeve dhe taksave mbi burimet, konsumin, kapitalin, pasurinë, punën dhe të ardhurat; si dhe
- Të sigurojë që sistemi tatimor plotëson nevojat për të ardhura buxhetore që ka Shqipëria.

Dy drejtimet kryesore ku do mbështetet reformimi i sistemit tatimor shqiptar dhe ku do bazohet Strategjia e të Ardhurave Afatmesme (SAA 2022-2026) janë:

- a. Rishikimi dhe ridizenjimi i politikave tatimore nëpërmjet analizës së efekteve të politikave aktuale dhe korrigjimeve të nevojshme për periudhën afatmesme.**
- b. Përmirësimi i procedurave të administrimit tatimor dhe doganor me qëllim rritjen e efikasitetit të administratës fiskale nëpërmjet investimeve në teknologji, burime njerëzore dhe modernizim të procedurave operacionale**

KREU II: DIZENJIMI I POLITIKAVE TATIMORE

Politikat fiskale 2022- 2026

Në vitet 2014 – 2017, Shqipëria ka rritur gradualisht përqindjen e të ardhurave të mbledhura në raport me PBB-në, ndërkohë që pas vitit 2018 përgjithësisht ka pasur përqindje të qëndrueshme të tyre. Ecuria e mbledhjes së të ardhurave është parashikuar të vazhdojë me një trend rrites të raportit Të ardhura/PBB-së edhe sipas parashikimeve të bëra në Kuadrin Makrofiskal 2022–2026 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ndërkohë, presioni për shpenzime dhe trendi i tyre rriten me rritme të shpejta. Nëse do ndërmerren ndryshime që lidhen me legjislacionin fiskal dhe mirëadministrimin tatimor, këto përqindje të të ardhurave ndaj PBB-së duhet dhe mund të rriten edhe më tej, duke suportuar në këtë mënyrë rritjen e presionit për shpenzime dhe duke garantuar realizimin e objektivave për deficitin buxhetor dhe borxhin publik. Shtesa në të ardhurat e buxhetit të shtetit lidhet më së shumti me 4 faktorë kryesorë:

- i. Të ardhura shtesë nga Tatimet Indirekte – tatimet mbi konsumin. Këto të ardhura do të sigurohen kryesisht nga analiza e impakteve të deritanishme dhe abrogimi i përjashtimeve nga TVSH të kategorive të caktuara të furnizimit të mallrave dhe shërbimeve, të cilat e kanë përfunduar misionin e tyre për të cilin ishin dizenuar, apo që kanë rezultuar jo me impaktet pozitive të pritshme.
- ii. Të ardhura shtesë nga Tatimet Direkte – tatimet mbi të ardhurat për periudhën 2022 – 2026. Këto të ardhura do të sigurohen nga ndryshime në sistemin ligjor që prekin tatimet direkte të tilla si abrogimi i tarifave preferenciale sektoriale, ndryshimi i skemës së taksimit të bizneseve të caktuara etj. Edhe në dizenjimin e ndryshimeve të sistemit të tatimeve direkte, analiza e thelluar përcakton ato masa që nuk janë më të nevojshme apo që e kanë realizuar qëllimin e tyre.
- iii. Të ardhura shtesë nga taksat e pasurisë se paluajtshme. Këto të ardhura do të sigurohen nëpërmjet rishikimit të sistemit tatimor mbi këto pasuri, rritjes së eficiencës së Kadastrës Fiskale, si dhe rishikimit të përjashtimeve të shumta nga këto taksa, përfshirë edhe rishikimin e tarifës së taksës për kategori të caktuara rezidenciale apo disponim të pasurive rezidenciale të dyta dhe të treta.
- iv. Të ardhura shtesë nga strategjia dhe reformat fiskale që do ndërmerren dhe që lidhen me mirëadministrimin fiskal.


Dizenjimi i një sistemi tatimor të qëndrueshëm dhe nevoja për rritjen e kapaciteteve institucionale me qëllim hartimin dhe impelentimin e reformave.

- Rritja e besimit, stabilitetit dhe qëndrueshmërisë në sistemit tatimor shqiptar, të cilat çojnë drejt zbatimit vullnetar të ligjit tatimor nga publiku tatimpagues, mund të realizohen nëpërmjet krijimit të një sistemi të qëndrueshëm, të parashikueshëm dhe frenues ndaj ndryshimeve të shpeshta. Nëpërmjet reduktimit të ndryshimeve të shpeshta në sistemin tatimor (ndryshimeve ligjore, ndryshime të shkallëve tatimore, ndryshime të përjashtimeve nga tatimet, etj), qëndrueshmëria dhe besimi i komunitetit të biznesit në sistemin tatimor rritet, duke sjellë efekte pozitive në pajtimin vullnetar me tatimet, çka rrit nivelin e vetdeklarimit dhe pagimit të detyrimeve tatimore ligjore.

- Forcimi i kapaciteteve me qëllim kryerjen e analizave të detajuara dhe të thelluara të politikave fiskale të ndjekura, efekteve të tyre në ekonomi dhe në sjelljen e tatimpaguesve janë të domosdoshme për dizenjimin e perspektives dhe të ndryshimeve që mund të bëhen, në funksion të përmirësimeve të sistemit dhe rritjes së transparencës së tij.
- Forcimi dhe rritja e kapaciteteve në strukturat e administratës fiskale (Tatimore dhe Doganore) si dhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (Departamentet e Makroekonomisë dhe ai Fiskal), me qëllim menaxhimin e implementimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave, përbën element të rëndësishëm për mbarëvajtjen e procesit dhe suksesin e kësaj Strategjie.

Tatimet indirekte - Tatimet mbi Konsumin 2022-2026

Mallrat & Sherbimet- Në % të PBB



Grafiku 3: Përqindja e tatimeve indirekte krahasuar me vendet e rajonit

Tatimet mbi konsumin ose tatimet indirekte siç janë TVSH-ja dhe Akciza, zënë një peshë të konsiderueshme në të ardhurat e mbledhura nga DPT dhe DPD. Në 10 vitet e fundit ato përbëjnë 11.4% të PBB-së dhe rreth 46.4% të të ardhurave tatimore gjithsej. Për shkak të rëndësisë dhe peshës së madhe që kanë në të ardhurat tatimore, kujdesi që duhet kushtuar në lidhje me politikat që duhet të ndiqen për tatimet mbi konsumin duhet të jetë i veçantë.

Theksojmë se rritjet që parashikohen në programet afatmesme buxhetore nga të ardhurat e tatimeve të konsumit, bazuar edhe në këtë Strategji, do të projektohen kryesisht si rezultat i analizës dhe rishikimit të përjashtimeve të shumta, reduktimit të rimbursimeve jo-ekonomike, apo eliminimit të disa normave preferenciale që aplikohen, por të cilat nuk kanë rezultuar efektive. Pra në përgjithësi, Strategjia nuk synon rritjen e mëtejshme të shkallëve tatimore të tatimeve mbi konsumin, apo futjen e llojeve të reja të tatimeve. Përkundrazi, rritja e të ardhurave në buxhet do të vijë si pasojë e rishikimit të politikave ekzistuese përjashtuese,

reduktimit të disa rimbursimeve joefektive apo eliminimin e disa normave të reduktuara në zërin e akcizës. Peshën më të madhe të efekteve pritet ta sjellë reduktimi i përjashtimeve joefektive të përcaktuara në ligjin nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, apo përjashtimeve të cilat do të zëvendësohen nëpërmjet politikave subvencionuese për produkte, sektorë apo operatorë specifikë.

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar është burim kryesor dhe mjaft i rëndësishëm në strukturën e të ardhurave tatimore, duke siguruar rreth 8.7% të PBB-së në 10 vitet e fundit. Shqipëria aplikon TVSH me bazë të gjerë, me normë standarde 20% dhe normë të reduktuar 6%. Legjislacioni në fushën e këtij tatimi është në përputhje të pjesshme me Direktivën 2006/112/CE të Këshillit “Mbi sistemin e përbashkët të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar”, të ndryshuar.

Asistenca Teknike e FMN-së, por edhe sugjerimet dhe konkluzionet e Bankës Botërore dhe strukturave të Bashkimit Europian, kanë theksuar në diagnozat e tyre se në ligjin për TVSH-në, gjatë viteve të fundit është rritur numuri i përjashtimeve për mallra apo shërbime të ndryshme, si dhe janë rritur furnizimet që trajtohen me shkallë të reduktuar, dhe për këtë arsye nevojiten analiza të thelluara për efektivitetin real të tyre, pasojave që kanë sjellë, përmbushjen e qëllimeve për të cilat janë dizenuar, dhe më tej adresimin e këtyre ndryshimeve mbi bazën e analizave dhe konkluzioneve.

Nëse do supozonim se çdo mall dhe shërbim i furnizuar në Republikën e Shqipërisë do të ngarkohej më TVSH sipas normës standarde 20%, rezulton se humbja e të ardhurave tatimore për shkak të përjashtimeve/normave të reduktuara të TVSH-së të parashikuara në legjislacion, llogaritet në rreth 4,7-4,8 për qind e PBB-së ose rreth 80 miliard lekë, e cila përbën rreth 50% të shumës së arkëtuar në TVSH. Pra gjysma e TVSH-së teorike që duhet të arkëtohet në buxhetin e shtetit, “humbet” për shkak të përjashtimeve/tarifave të reduktuara që janë miratuar me ligj.

Reduktimi gradual dhe dhe eliminimi i përjashtimeve të papërshtatshme dhe pa efekt ekonomik thelbesor nga TVSH-ja, ka impakt shumë të rëndësishëm, pasi e bën TVSH-në më transparente dhe më të thjeshtë për tu mbledhur dhe administruar. Është e nevojshme që të eliminohen një sërë përjashtimesh nga ky tatim, pasi nuk kanë efekt dhe nuk realizojnë qëllimet për të cilat janë dizenuar, si dhe e komplikojnë në mënyrë të panevojshme sistemin dhe e bëjnë të vështirë administrimin efikas të tij. Në vende me sistem fiskal relativisht të ri sikurse është vendi ynë, reduktimet e tarifave në tatimeve e konsumit, apo edhe përjashtimet nga tatimi të tyre, nuk shkojnë plotësisht në favor të konsumatorit, qytetarit, për të cilin janë dizenuar por këto reduktime të normave tatimore apo përjashtime nga tatimi “përfitohen” nga sipërmarrjet në zinxhirin e transaksioneve ku kalon malli/shërbimi.

Për këtë qëllim, lista e përjashtimeve/tarifave të reduktuara të tatimit duhet të jetë objekt analizimi dhe matje performace të vazhdueshme, sikurse çdo përjashtim/tarifë e reduktuar apo incentivë tjetër duhet të ketë karakter të përkohshëm dhe jo të përhershëm.

Rishikimet e politikave tatimore të synuara për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar

Rishikimi i politikave tatimore në Tatimin mbi Vlerën e Shtuar do të synojë heqjen apo vendosjen e afateve kufizuese për përjashtime/tarifa të reduktuara të implementuara në vitet e mëparshme. Së pari do analizohen incentivat dhe përjashtimet/tarifat e reduktuara të cilat kanë qënë politikë e brendshme e vendit tonë, dhe më pas incentivat/përjashtimet/tarifat e reduktuara të përfshira të Direktivën 2006/112/CE e Këshillit dhe Direktivave amenduese të saj.

Në këtë kuadër analiza e rishikimeve do përfshijë:

- a. analizën dhe rishikimin e listës së përjashtimeve nga TVSH në import dhe brenda vendit;
- b. analizën e efekteve reale mbi publikun të përjashtimit nga TVSH të shërbimeve shëndetsore dhe shërbimeve të edukimit që furnizohen nga sektori privat;
- c. analizën në lidhje me mundësinë e shtrirjes së TVSH-së mbi furnizimin e shërbimeve financiare të bankave dhe institucioneve të tjera financiare;
- d. analizën në lidhje me mundësinë e shtrirjes së TVSH-së mbi furnizimin e shërbimeve të sigurimit;
- e. rishikimin e skemës së fermerit dhe zëvendësimin e saj me politika subvencionuese mbi bazë produkti;
- f. rishikimin e efekteve reale mbi konsumatorët të normës së reduktuar të TVSH-së 6 % për disa kategori furnizimesh si akomodimi, etj;
- g. analiza e pragur të regjistrimit në TVSH, pasojat dhe problematika;
- h. analiza dhe adresimi i problematikës së pragut të regjistrimit në TVSH për veprimtari specifike ku operohet me tarifa të miratuara shtetore si shërbimi i noterisë, shërbimi përmbartimor privat, etj;
- i. Analiza e përjashtimit nga TVSH-ja e inputeve bujqësore. Zëvendësimi i tyre me subvencione direkte të sektorit. Zbatimi do të fillojë nga viti 2022 e në vijim.

a. Shërbimet shëndetsore dhe ato arsimore të furnizuara nga sektori privat.

Furnizimi i dy kategorive të mësipërme të shërbimeve ka qënë herë i përjashtuar dhe herë i taksueshëm në këto 24 vite të implementimit të TVSH-së. Furnizimi i shërbimeve shëndetsore nga sektori privat ka qënë fillimisht i përjashtuar. Më vonë, pas vitit 2010, për këtë shërbim aplikohet TVSH 10 % dhe nga janari 2014 trajtohet përsëri si furnizim i përjashtuar nga TVSH. Ndërkohë, edhe furnizimi i shërbimeve edukative-arsimore nga sektori privat ka qënë fillimisht furnizim i përjashtuar, më pas, u trajtua si furnizim i tatueshëm me shkallë tatimore 20%, dhe nga viti 2013 e në vazhdim trajtohet si furnizim i përjashtuar.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë do analizoje impaktin e këtyre përjashtimeve, përfitimet reale të konsumatorëve, marzhin e fitimit të realizuar nga operatorët

ekonomikë privatë dhe do propozojë ndryshimet e nevojshme, nëse do shihet e arsyeshme, ndryshime të cilat do mund të implementohen në një periudhë afatmesme 3-4 vjeçare.

- b. Shërbimet financiare të bankave dhe institucioneve të tjera financiare do jenë objekt i analizës nga strukturat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me qëllim që në periudhë afatmesme të rishikohet skema e taksimit të tyre ose në formën e “tarifës së transaksionit” ose në formën e TVSH-së me tarifë të reduktuar apo atë standarde. Skema e taksimit që mund të aplikohet do të jetë në varësi të zhvillimeve ndërkombëtare në këtë fushë. Në vitet e fundit, është diskutuar gjërësisht taksimi i transaksioneve financiare bankare. Në fakt, deri tani, Direktiva 2006/112/CE e Këshillit “Mbi sistemin e përbashkët të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar”, e ndryshuar, i trajton shërbimet financiare si furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja. Ndërkohë, në kontekstin global, janë diskutuar edhe opsione për vendosjen e një takse të dedikuar në përqindje mbi transaksionet bankare. Të dhënat e deklaruara nga bankat e nivelit të dytë në Shqipëri, tregojnë se 40-45 % e të ardhurave të biznesit bankar sigurohen nga shërbimet financiare, ndërkohë që vetëm 55-60 % e të ardhurave sigurohen nga veprimtaria kryesore bankare-kredidhënia.

Shërbimet e sigurimit. Sigurimi i jo-jetës ka qënë në skemën e TVSH-së deri në vitin 2014. Nga 1 Janari 2015 u trajtua si furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja, në përputhje me direktivën e BE-së. Njëkohësisht, bazuar në përvojën ndërkombëtare, mbi tarifën e sigurimit u aplikua “taksa e primit të sigurimit” në masën 3 % deri në vitin 2016, dhe më pas 10 %. FMN sugjeron që sigurimi i jo-jetës, të futet në skemën e TVSH-së me tarifë standarde 20 %. Futja në skemën e TVSH-së do të shoqërohet me heqjen e “taksës së primit të sigurimit”. Këto ndryshime do analizohen të lidhura me pasojat e tyre mbi konsumatorin dhe kategoritë e sigurimeve dhe nëse shihet oportune përmirësimi i skemës së taksimit, mund të implementohen në periudhë afatmesme.

- c. Futja e skemës së TVSH-së në shitjen e parë të banesave të reja rezidenciale. Ligji aktual e ka përjashtuar aplikimin e TVSH-së për shitjen e banesave. TVSH-ja aplikohet për procesin e ndërtimit të tyre nga subjektet ndërtuese, ndërkohë që shitja prej ndërtuesve është furnizim i përjashtuar. Trajtimi si furnizim i përjashtuar ka pasur parasysh përballimin e çmimeve të shitjes së apartamenteve nga publiku, pasi aplikimi i TVSH-së do i rriste çmimin e shitjes. Kjo politikë është ndjekur nga viti 1996 e në vijim.
- d. Analiza e impaktit të deritanishëm dhe politika e ardhshme në lidhje me furnizimin e mallrave/shërbimeve për të cilat aplikohet tarifa e reduktuar 6 % e TVSH-së.

Ligji shqiptar i TVSH-së, parashikon aplikimin e normës së reduktuar 6 % të TVSH-së për një sërë furnizimesh si më poshtë:

- furnizimi i shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese;
- furnizimi i shërbimit të ofruar brenda strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special”;
- furnizimi i shërbimit të akomodimit dhe restorantit, me përjashtim të pijeve, nga strukturat, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”;
- furnizimi i shërbimit të reklamave nga media audiovizive;
- furnizimi i mjeteve të transportit publik të licencuar të udhëtarëve me autobus me nëntë plus një vende ose më shumë, vetëm me motor elektrik;
- furnizimi i librave të çdo lloji.
- Furnizimi i ndërtimit të infrastrukturës sportiv.

Për kategoritë e mësipërme të furnizimeve, të cilat trajtohen me tarifë të reduktuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- ✓ do analizoje impaktin e tyre në rritjen e qarkullimit sektorial dhe përfitimeve të tjera që ka pasur ekonomia shqiptare dhe konsumatori;
- ✓ do vlerësojë nëse secila nga këto incentiva e ka përmbushur qëllimin për të cilën ishte dizenuar;
- ✓ do propozojë kohën dhe afatin oportun të heqjes së incentivave të cilat kanë përmbushur qëllimin;
- ✓ do analizoje çdo tarifë të reduktuar për çdo lloj furnizimi malli dhe shërbimi, nëse ajo është në përputhje me Direktivën 2006/112/CE, duke marrë njëkohësisht masa për të qënë të përgatitur në negociatat e Kapitullit 16 lidhur me afatin e ruajtjes së tarifave tatimore jo në linjë me Direktivën Europiane.

e. Rrishikimi i listës së përjashtimeve nga TVSH.

Nenet 51, 53, 54 dhe 56 të Ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar kanë parashikuar furnizimet e përjashtuara nga TVSH-ja. Lista e furnizimeve të përjashtuara do të rishikohet sipas parimeve të mëposhtme:

- do trajtohen si furnizime të përjashtuara, ato lloj furnizimesh të cilat lejohen të trajtohen si të tilla nga Direktiva 2006/112/CE e Këshillit.
- do rishikohet lista e përjashtimeve nga TVSH në import, me synimin e heqjes së përjashtimeve të panevojshme. Në kushtet kur skema e rimbursimit të TVSH-së nga viti 2020 e në vijim funksionon brenda kornizave dhe afateve të përcaktuara në legjislacionin për rimbursimet, disa përjashtime në import, të cilat ishin akorduar 10 apo 15 vite më parë, për shkak të problematikës dhe vonesave në rimbursimin e TVSH-së për investitorët e medhenj, nuk ka arsye objektive të vazhdojnë më tej. Këto ndryshime mund të implementohen nga viti 2022 e në vijim

Rrishikimi i listës së përjashtimeve nga TVSH synohet të realizohet duke zbatuar këto parime:

- do hiqen fillimisht përjashtimet nga TVSH të cilat nuk janë në përputhje me Direktivën e TVSH-së;
 - do analizohen për efektivitetin e tyre, përjashtimet të cilat janë në përputhje me Direktivën e TVSH-së.
- f.** Eliminimi i tarifës zero të TVSH-së për furnizimet e shërbimeve që kryejnë nënkontraktorët e fason-it për kontraktorin kryesor-eksportues, dhe aplikimi nga ata i tarifës standarde 20%. Aplikimi i tarifës zero për furnizimin e shërbimeve të ofruara nga nënkontraktorët e industrisë fason, për kontraktorët kryesorë eksportues filloi të aplikohet në janar 2019. Qëllimi i aplikimit të tarifës zero ishte lehtësimi i kontraktorit kryesor nga stoku i TVSH-së së rimbursueshme, që vonohej të kthehej nga administrata tatimore.
- g.** Reduktimi i numrit të “zonave të lira”, “magazinave fiskale” dhe rregjimeve doganore pezulluese, me qëllim monitorimin më të mirë të levizjes së mallrave dhe zbatimin e masave shtrënguese.

Legjislacioni tatimor/doganor shqiptar përjashton tatimpaguesit që veprojnë në zona të veçanta nga tatimet/taksat indirekte dhe/ose nga detyrimet doganore. Zona të veçanta konsiderohen “magazinat e lira” sipas konceptit të Kodit të vjetër Doganor, “zonat e lira” sipas konceptit të Kodit të ri Doganor, “magazinat fiskale”, dhe “zonat e zhvillimit teknologjik”.

Zona të veçanta tatimore zakonisht krijohen për të lehtësuar barrën administrative për prodhuesit e mallrave që eksportohen ose për importuesit. Shumë vende krijojnë zona të veçanta tatimore për të stimuluar investimet dhe punësimin.

Meqenëse administrimi i zonave të veçanta të taksave, siç janë “zonat e lira”, apo “magazinat fiskale” është i vështirë, përdorimi i tyre duhet të jetë shumë i kufizuar. Nëse krijimi i një zone të lirë nuk mund të shmanget, efektet e tyre të mundshme negative duhet të kufizohen rreptësisht:

- i. zona e lirë duhet të izohet fizikisht dhe të kontrollohet në mënyrë efektive;
- ii. privilegjet duhet të kufizohen rreptësisht në ato që lidhen drejtpërdrejt me një regjim liberal të tarifave doganore, pa stimuj të parashikuar për tatimet direkte ose taksat mbi pasurinë, si dhe duke mos akorduar asnjë përfitim për tatimpaguesit që veprojnë jashtë zonës.

Me qëllim adresimin e problematikës në funksionimin e zonave të vecanta dhe për të minimizuar rrishtin e evazionit dhe shmangies nga detyrimet tatimore, duke filluar në vitin 2025 do të rishikohen procedurat e akordimit të incentivave për zonat e vecanta me synim reduktimin e numrit të tyre.

h. Rregjistrimit për TVSH-në

Asistenca teknike e FMN-së sugjeroi rritje të pragut të regjistrimit në TVSH, në 8 milion lekë në vit, e shoqëruar kjo me lejimin e regjistrimit vullnetar në TVSH të tatimpaguesve me qarkullim 5-8 milion lekë, por jo më poshtë se 5 milion. Po ashtu u sugjerua që pragu të jetë unik për të gjitha kategoritë e tatimpaguesve. Ky sugjerim u implementua në legjislacionin tatimor me përjashtim të pragut i cili nga 8 milion u rrit në 10 milion lekë në vit.

Para këtij ndryshimi, pragu i regjistrimit në TVSH ishte qarkullimi mbi 2 milion lekë në vit, ndërkohë që për tatimpaguesit që ushtrojnë profesione të lira dhe furnizim të shërbimeve të akomodimit, pragu i regjistrimit ishte zero.

Tatimpagues të regjistruar në skemën e TVSH-së në vitin 2020 të ndarë sipas nivelit të qarkullimit janë si në tabelën më poshtë:

Tatimpaguesit sipas xhiros	Numer tatimpaguesish	Vlere e tatueshme ne shitje	Tvsh ne shitje	TVSH e detyrueshme për tu paguar (pa përfshirë kreditimin e mbartur)	Shuma paguar me deklarate
0-2 milion	30,203	12,647,489,757	2,529,497,951	1,605,026,396	504,148,340
2-5 milion	11,794	27,028,993,646	5,405,798,729	2,727,130,812	1,236,775,759
5-8 milion	4,559	20,040,113,450	4,008,022,690	1,932,334,304	933,474,660
8-10 milion	1,760	10,711,192,541	2,142,238,508	985,598,968	492,098,049
10-14 milion	2,605	20,564,309,725	4,112,861,945	1,805,871,476	897,181,618
mbi 14 milion	11,705	1,409,908,404,605	281,981,680,921	65,522,426,595	41,937,872,981
Total	62,626	1,500,900,503,724	300,180,100,745	74,578,388,551	46,001,551,407

Tabela 2 Tatimpaguesit e regjistruar në skemën e TVSH-së në vitin 2020

Në segmentin e qarkullimit 0 - 2 milionë lekë operojnë 30,200 tatimpaguese në TVSH. Qarkullimi i deklaruar për efekt të TVSH-së është 12.7 miliardë lekë, TVSH e llogaritur për shitjet nga ky grup tatimpaguesish është 2.5 miliardë lekë, ndërsa TVSH-ja e detyrueshme për t'u paguar është 1.6 miliardë lekë.

Në segmentin e qarkullimit 2 - 8 milionë lekë operojnë 16,350 tatimpagues. Qarkullimi i deklaruar për efekt të TVSH-së është 47.1 miliardë lekë, TVSH e llogaritur për shitjet nga ky grup tatimpaguesish është 9.4 miliardë lekë, ndërsa TVSH-ja e detyrueshme për t'u paguar është 4.6 miliardë lekë.

Në segmentin e qarkullimit 8 - 10 milionë lekë operojnë 1,760 tatimpagues. Qarkullimi i deklaruar për efekt të TVSH-së është 10.7 miliardë lekë, TVSH e llogaritur për shitjet nga ky grup tatimpaguesish është 2.1 miliardë lekë, ndërsa TVSH-ja e detyrueshme për t'u paguar është 1 miliardë lekë.

Me rritjen e pragut të regjistrimit në TVSH deri në 10 milionë lekë në vit, rezulton se krahasuar me skemën e vjetër, dalin jashtë skemës se TVSH-së rreth 48 mijë tatimpagues me qarkullim të deklaruar 70.4 miliardë lekë me TVSH të llogaritur për shitjet 14 miliardë lekë dhe TVSH potencialisht për t'u paguar 3-4 miliardë lekë.

Rritja e pragut nga 8 milionë lekë në vit që ka sugjeruar FMN, në 10 milion lekë në vit, i cili aplikohet aktualisht, nuk shkakton pasoja në skemë, pasi në segmentin 8-10 operojnë 1.760 tatimpagues, të cilët kanë paguar 490 milion lekë TVSH në vit, por jo të gjitha shitjet mund

të supozohen për konsumatorët finale, dhe një pjesë e TVSH-së së llogaritur është kredituar nga tatimpagues të tjerë. Pra efekti real në uljen e të ardhurave nga ky segment mund të llogaritet në 200-300 milionë lekë në vit.

Duhet patur parasysh që heqja nga skema e TVSH-së së këtij grupi tatimpaguesish do të reduktojë TVSH-në e llogaritur prej tyre dhe që u faturohet tatimpaguesve të tjerë që janë në skemën e TVSH-së. Pra efekti në uljen e të ardhurave nga rritja e pragut të TVSH-së duhet të marrë në konsideratë vetëm furnizimet që tatimpaguesit me qarkullim 0-10 milion bëjnë për konsumatorët finalë. Gjithashtu duhet marrë në konsideratë edhe teprica kreditore që trashëgojnë tatimpaguesit e TVSH-së, e cila redukton çdo muaj TVSH-në e pagueshme. Në këto kushte analize dhe supozimesh, me rritjen e pragut të TVSH-së në 10 milion lekë në vit, shifra vjetore e uljes së të ardhurave nga TVSH-ja teorike do të reduktohet në nivelin 3-4 miliardë lekë të humbjes së arkëtimeve nga TVSH-ja.

Por njëkohësisht duhet të merret në konsideratë se heqja nga skema e TVSH-së të këtij grupi për rreth 48,300 tatimpagues, do lejojë administratën tatimore të fokusohet thellësisht në kontrollin e tatimpaguesve të mesëm e të mëdhenj të cilët do ngelen në skemën e TVSH-së.

i. Pragu i TVSH-së për Profesionet e lira

Heqja e pragut të regjistrimit dhe futja në skemën e TVSH-së të profesioneve të lira dhe furnizimit të shërbimeve të akomodimit, është bërë me qëllim aplikimin e një pragu të vetëm të TVSH-së. Por brenda grupit të profesioneve të lira ka aktivitete të cilat deformohen nga pragu unik, dhe keto janë ato lloj veprimtarish, tarifat e shërbimit të cilave përcaktohen nga organet shtetërore të tilla si shërbimi i noterisë, ai i përbarimit, etj. Nëse për profesionet e tjera të lira tarifata e shërbimit janë të liberalizuara sipas kërkesës dhe ofertës, për shërbime të tilla si noteria apo përbarimi, pragu i TVSH-së krijon konkurrencë jo të drejtë, pasi mbi tarifën e përcaktuar nga organi shtetëror, subjektet e regjistruara në TVSH do ngarkojnë tatimin, ndërsa subjektet jashtë skemës së TVSH-së nuk ngarkojnë 20% tatim mbi tarifën e shërbimit. Për këtë arsye shihet më oportune që të rishikohet pragu për këto kategori shërbimesh me qëllim garantimin e konkurrencës së drejtë që nuk ndikohet nga taksat.

j. Skema e kompensimit të fermerit

Skema e kompensimit të fermerit duhet të eliminohet dhe të zëvendësohet me mekanizma të tjerë mbështetës të sektorit bujqësor, të cilat janë shumë më të lehta për tu monitoruar dhe kontrolluar. Teorikisht, në një rregjim normal të TVSH-së, kosto më të larta nënkuptojnë TVSH më të lartë në blerje, ndërkohë që nën skemën aktuale ky efekt mungon dhe niveli i kompensimit nuk lidhet me nivelin e blerjeve të fermerit. Për më tepër, kompensimi real që bën blerësi, nëpërmjet mekanizmit të cmimit të grumbullimit nga fermeri është i panjohur. Ka shumë tregues që vërtetojnë se blerësit nuk e kalojnë tërësisht kompensimin tek fermerët, sidomos kur aplikohet norma 6 %.

Mbështetja e bujqësisë duhet të kryhet me mekanizma direkte subvencionues, që garantojnë se subvencioni shkon tek fermeri. Si shembull pozitiv mund të sjellim subvencionimin e prodhuesve të qumështit.

Zhvillimi i sektorit bujqësor ka qënë prioritet i Qeverisë, e cila e ka mbështetur me masa të ndryshme stimuluese dhe lehtësuese të tilla si:

- Investimet në përmirësimin e tokës bujqësore;
- Investimet në rrjetet e kullimit dhe kanalizimeve;
- Mbështetja e fermerëve me fond nga programet e asistencës të BE (Ipard 1, Ipard 2);
- Mbështetje me subvencionime nga buxheti i shtetit;
- Skema e furnizimit “naftë pa akcize”;
- Mbështetje nëpërmjet sistemit fiskal duke lehtësuar sektorin bujqësor nga tatimet dhe taksat.

Pra sektori i bujqësisë ka qënë i mbështetur dhe i stimuluar ndër të tjera edhe me mjaft avantazhe fiskale. Por ndërkohe ne jemi të bindur se avantazhet fiskale nuk janë mënyra dhe rruga më e mirë për stimulimin e sektoreve dhe industrive të caktuara. Perëndrazi, ato shpesh deformojnë tregun dhe krijojnë avantazhe vetëm për grupe të caktuara. Në vend të avantazheve fiskale që shpesh janë deformuese, synohet që të nxitet dhe stimulohet subvencionimi direkt i prodhuesit. Pse avantazhet fiskale mund të deformojnë konkurrencën dhe mund të aplikohen në mënyrë jo proporcionale? Marrim si shembull kompensimin e fermerëve. Skema është konceptuar si TVSH e fermerit por në thelb është subvencion nga paratë e buxhetit të shtetit, por të dhëna fermerit nëpërmjet sistemit të faturimit nga grumbulluesit. Po të shohim të dhënat, rezulton se nga rreth 350 mijë ferma që deklarohen në Shqipëri, nga të cilat mbi 65 mijë janë pajisur me NIPT, vetëm 7,900 prej tyre shesin tek grumbulluesit dhe “përfitojnë 6% TVSH”, pra vetëm 12% e fermerëve të pajisur me NIPT dhe 2,2 % e totalit të fermave. Subvencionimi direkt i fermerit do të lejonte një shpërndarje më të drejtë të fondeve që ka alokuar buxheti i shtetit për sektorin e bujqësisë dhe kjo duhet të jetë rruga më e drejtë e mbështetjes së bujqësisë.

k. TVSH-ja e inuteve bujqësore

Në fund të vitit 2019, Kuvendi hoqi TVSH-në 20 % të inuteve bujqësore. Normalisht çmimi i inuteve duhej të ulej automatikisht me -20 %, ndërkohë që të dhënat e vrojtimit të MBZHR për vitin 2019 tregojnë se jo i gjithë përfitimi nga heqja e TVSH-së 20 % ka shkuar tek fermerët të cilët duhej ti blinin këto inute me çmime -20% krahasuar me vitin 2018 e më parë. Të dhënat e vrojtuar të emimeve në vitin 2019 tregojnë se rreth 30-40 % e përfitimit nga heqja e TVSH-së nuk ka shkuar tek fermeri por tek importuesi dhe zinxhiri i tregtuesve. Është e vërtetë se si rezultat i pasojave të pandemisë globale, në kuadrin e rritjes së çmimeve, në vitin 2021 janë rritur edhe çmimet e inuteve, por kjo ka qënë tendencë e përgjithshme që mund të përfshijë jo vetëm çmimet e inuteve por edhe të produkteve, pra nuk ka gjasa që të ndodhë vetëm rritja e kostove të prodhimit. Për këtë qëllim do të trajtohen me shkallë të reduktuar të TVSH-së 10 për qind furnizimi i inuteve bujqësore.

Akciza

Shqipëria aplikon një grup gjithëpërfshirës të akcizave, të cilat janë të harmonizuara me direktivën e BE-së. Ligji nr. 61, datë 24.05.2012, “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar është i përafuar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 2008/118/KE, datë 16 dhjetor

2008 “Lidhur me masat e përgjithshme mbi taksën e akcizës”. Akciza është e pagueshme për disa kategori mallrash që importohen apo prodhohen brenda vendit dhe përfshin pijet alkoolike, duhanin, nënprodukte të naftës, kafënë, bateritë, gomat, etj. Akciza zë rreth 11% të të ardhurave tatimore. Rreth 55% e të ardhurave nga akciza vijnë nga nënproduktet e naftës, 35% nga nënproduktet e duhanit dhe pjesa e mbetur prej 10% nga kategoritë e tjera të mallrave të akcizueshme. Aplikohet akcizë specifike mbi produktet, ndërkohë që në ligj ka një kalendar rritje të paracaktuar deri në vitin 2021 për nivelin e akcizës së duhanit.

Problematika me akcizat

Shqipëria aplikon akcizat me tarifë specifike për njësi. Niveli i akcizave të mallrave kryesore që ngarkohen me akcizë si karburantet dhe duhanet, është përgjithësisht më i ulët se nivelet e akcizave që zbatohen nga vendet e BE-së apo ato të parashikuara në Direktivën e Këshillit 2008/118/KE, datë 16 dhjetor 2008.

Problematikat kryesore në lidhje me akcizat janë:

Duke qënë se ligji i akcizës ka parashikuar tarifa specifike akcizë për mallrat e akcizueshme, niveli i të ardhurave nga akciza nuk reflekton indeksin vjetor të çmimeve, sikurse ndodh me tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Në vendin tonë, për disa mallra të akcizueshme sikurse janë duhanet, nuk aplikohet skema e kombinuar e taksimit që përfshin edhe një tarifë specifike akcize për njësi produkti, por edhe një tarifë me përqindje akcize mbi çmimin e shitjes së produktit. Kjo skemë e kombinuar aplikohet në disa vende.

Niveli i parashikuar i akcizave në ligjin shqiptar është përgjithësisht më i ulët se niveli i akcizës që zbatohet nga vendet e BE-së, por edhe nga nivelet minimale të akcizës të rekomanduara në Direktivën e Këshillit 2008/118/KE, datë 16 dhjetor 2008 “Lidhur me masat e përgjithshme mbi taksën e akcizës”.

Ndryshimet e synuara për Akcizat:

- a. **Unifikimi i nivelit të akcizës për produktet verë dhe birra nëpërmjet eliminimit të diferencës në nivelin e akcizës ndërmjet prodhuesve të vegjël dhe prodhuesve të mëdhenj**

Akciza e birrës për prodhuesit e vegjël, të cilët prodhojnë më pak se 200 mijë hl në vit është gati sa gjysma e akcizës që aplikohet për prodhuesit e mëdhenj të cilët prodhojnë mbi 200 mijë hl në vit. Ndërsa akciza e verës për prodhuesit e vegjël është rreth një e treta e normës së rregullt të akcizës që zbatohet për prodhuesit e mëdhenj. Niveli i akcizës për prodhuesit e mëdhenj nuk konsiderohet i nivelit të lartë, dhe nuk ka gjasa që unifikimi i akcizës në nivelin e lartë, të krijojë problematika mbi operatorët dhe çmimet e shitjes së produkteve.

Shkalla e diferencuar do synohet të hiqet duke filluar nga viti 2022 për verën dhe 2023 për birrën.

b. Ulje e sasisë së pataksuar me akciza të pijeve alkoolike që përdoren për vetkonsum.

Do rishikohet sasia e pijeve alkoolike objekt akcize që trajtohen si vet konsum nga prodhuesit dhe nuk ngarkohen me akcizë, kjo kryesisht për rakinë dhe verën prodhim vendi.

c. Heqje e përjashtimeve dhe vendosja e ngarkesës fiskale për karburantet me destinacion anijet dhe jahtet që përdoren për qëllime private luksi.

Vendosja e një ngarkese fiskale për këtë destinacion të karburanteve do fillojë nga viti 2022.

d. Përfshirja në ligjin e akcizës të detyrimit për indeksimin automatik të tarifave specifike të akcizës së mallrave.

Për arsye administrimi, ligji shqiptar parashikon aplikimin e tarifave specifike të akcizës për cdo kategori malli të akcizueshëm. Ndryshe nga TVSH-ja, e cila është tatim add valorem, aplikimi i tarifave specifike, nuk reflekton rritjen e indeksit të çmimeve të konsumit të mallrave, mbi nivelin e akcizës që aplikohet. Normat specifike të akcizave duhet të azhurnohen në një bazë të rregullt për të parandaluar erozionin

- Indeksi vjetor i çmimeve në 10 vitet e fundit është rritur mesatarisht 1.5-2.2% në vit, me këtë përqindje parashikohet të rriten edhe nivelet e akcizave të mallrave të akcizueshme;
- Ky indeksim do të bëhet për produktet e akcizës me përjashtim të produkteve të duhanit, për të cilat në ligjin e akcizave është parashikuar një skedul i rritjes së tarifës specifike për periudhën 2022-2026;
- Niveli i aksizës që është mbledhur zakonisht në një vit, pa përfshirë produktet dhe nënproduktet e duhanit, llogaritet rreth 29-30 miliardë lekë, ndërkohë që indeksimi me koeficientin 1.7-2% do gjenerojë 500-600 milionë lekë në vit.

Duke filluar nga viti 2022, mbi tarifatat specifike të akcizës për mallra të ndryshme, do aplikohet cdo dy vjet rritja në vlerë absolute që merr në konsideratë rritjen e indeksit të çmimeve në përqindje të dy vitet paraardhëse.

e. Eliminim në industri të caktuara i përjashtimeve dhe rimbursimit nga taksat e qarkullimit dhe karbonit, si dhe nga akciza, dhe zëvendësimi i tyre me subvencionime direkte.

- ✓ Heqja e rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse për industrinë, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë (farmaceutika, tullat, çimento, birra dhe përpunimi i naftës brutë).
- ✓ Përjashtimi nga akciza i karburantit që shkon për serat me ngrohje.

Shfuqizimi i incentivave dhe përjashtimeve tatimore do shoqërohet me identifikimin e mekanizmave të tjerë stimuluese si subvencionet, të cilat lidhin përfitimin me produktet e hedhura në treg apo për përpunim.

f. Hartimi i një skeduli të ri për rritjen e nivelit të akcizës së cigareve dhe duhanit për periudhën 2022-2025.

Hartimi i një skeduli të ri për rritjen e nivelit të akcizës së duhanit dhe nën produkteve të tij për periudhën 2022-2025, me qëllim përafrimin me nivelin e akcizës që aplikohet në BE duke synuar dhe një unifikim të nivelit të akcizës ndërmjet duhanit dhe nënprodukteve të tij.

- Në skedulën e ri të akcizës parashikohet një rritje vjetore me 250 lekë për 1000 fije, ose 250 lekë/kg, sipas njësisë së vlerësimit për duhanin;
- Gjithashtu parashikohet një rritje vjetore me 2 lekë/ml për nikotinën e lëngshme, si dhe një rritje vjetore me 500 lekë/kg për nikotinën me qese, duhanin me ngohje dhe shisha, nargjilë;
- Sasi në ton e produkteve të duhanit dhe nënprodukteve të tij parashikohet të jetë mbi 3100 ton ose shprehur në fije mbi 2,8 milionë fije për vitin 2022;
- **Nga rritja e akcizës në grupin e duhaneve, parashikohet efekt vjetor në rritjen e të ardhurave nga akciza rreth +750 milion lekë.**

Për këtë qëllim, duke filluar nga viti 2022, është miratuar një skedul i ri për rritjen e nivelit të akcizës së cigareve dhe duhanit.

g. Unifikimi i akcizës për gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për çdo destinacionet përdorimi.

Unifikimi i akcizës për *“Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike”* për të gjitha destinacionet e përdorimit të tij në nivelin 6 lekë/litër.

Aktualisht niveli i akcizës për këtë nënprodukt është 8 lekë/litri nëse ai përdoret si lëndë djegëse për automjetet, dhe 0 lekë/litër për sasinë që përdoret nga konsumatorët e tjerë për çdo qëllim.

Nga sasia e importuar e kësaj lënde djegëse rezulton se:

- i. Rreth 2/3 (350 milionë litra) nuk ngarkohet me akcizë, që presupozon se nuk përdoret si karburant për automjetet;
- ii. Rreth 1/3 (180 milionë litra) e sasisë së importuar deklarohet për përdorim automjetesh dhe ngarkohet me akcizë;
- iii. Përvoja disa vjeçare ka treguar se administrimi i deklarimit të destinacionit të përdorimit të këtij nënprodukti është shumë i vështirë, duke krijuar mundësi për shmangie nga pagesa e akcizës, prandaj është parashikuar unifikimi i akcizës për këto produkte.

Unifikimi i akcizës në nivelin 6 lekë/litri do fillojë të zbatohet në 6 mujorin e dytë të vitit 2022.

Ndryshimet e synuara në taksat dhe tarifat kombëtare, përfshirë ato ambientale

Ligji nr.9975, datë 28.07.2008 ‘Për taksat kombëtare’, i ndryshuar ka përcaktuar llojet e taksave dhe tarifave kombëtare që zbatohen në Republikën e Shqipërisë, ku përfshihen 11 lloje taksash. Janë tre kategori taksash kombëtare: i) taksa e qarkullimit; ii) taksa e karbonit; iii)

taksa e ambalazheve plastike, të cilat kanë natyrë ambjentaliste dhe pavarësisht se mund të trajtohen si tatime indirekte janë pjesë e ligjit 'Për taksat kombëtare'. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Bankën Botërore do ndërmarrë në vitin 2022 studimin për analizimin, krahasimin, ndryshimin dhe adresimin e taksave të ambientit, duke u bazuar në përvojat më të mira ndërkombëtare, si dhe në strategjitë e miratuara nga Qeveria në lidhje me ruajtjen e mjedisit.

Gjithashtu, përmirësimet në sistemin e taksave kombëtare synojnë të sjellin kontribut pozitiv në të ardhurat e buxhetit. Për këtë qëllim masat e mëposhtme konsiderohen si të rëndësishme për t'u ndërmarrë:

a. Rishikimi i përjashtimeve nga taksat dhe tarifat kombëtare

Të gjitha përjashtimet nga taksat dhe tarifat kombëtare do jenë objekt rishikimi periodik, duke vlerësuar efektivitetin dhe efikasitetin e tyre. Ka disa përjashtime të parashikuara në ligj, të cila pjesërisht janë prezantuar me qëllim favorizimin e disa sektorëve prioritarë dhe pjesërisht me qëllim adresimin e problematikave me të cilat është përballur administrata tatimore. Sektorët prioritarë do të duhet të mbështeten qartësisht përmes transfertave direkte nga buxheti, në mënyrë që të jenë më të lehta për t'u monitoruar, ndërkohë që eliminimi i përjashtimeve nga pagimi i taksave, nuk çënon integritetin e sistemit tatimor.

b. Rritje e nivelit të takës së plastikës, taksim i ambalazheve të aluminit dhe inkurajim i riciklimit të tyre nëpërmjet mekanizmit të rimbursimit. Mbështetje për rregjimin e taksave ambientale nëpërmjet udhëzimeve mbështetëse.

Do të vlerësohet rritja e taksës mbi plastikën (kryesisht për ambalazhet plastike), si dhe vendosja e një takse mbi ambalazhet prej alumini, skema këto që nxisin riciklimin e tyre me anë të mekanizmit të rimbursimit. Taksa e plastikës konsiderohet jo e përshtatshme me disa norma dhe nivele të ulta tarifore. Duke marrë në konsideratë aspiratën e vendit tonë për t'u bërë destinacion i pëlqyer turistik, do të ishte veçanërisht e rëndësishme të sigurohen stimujt e duhur për ta mbajtur mjedisin të pastër. Ky objektiv do të synohet edhe nëpërmjet taksave më të larta që duhet të aplikohen për materialet që ndotin ambientin sikurse është plastika dhe kryesisht ambalazhet plastike. Dyfishimi i masës së taksës së plastikës, si dhe vendosja e një takse për ambalazhet e aluminit, pritet të gjenerojnë rritje të ardhurash me rreth 0.13 përqind të PBB-së në vit. Këto ndryshime do të mund të aplikohen duke filluar në vitin 2023.

c. Me qëllim shmangien e abuzimeve dhe përfitimeve të padrejta nga mjete lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi që furnizohen me karburant në zonat e lira doganore/magazinat doganore, parashikon vendosjen e një takse prej 40 lekë/litër mbi karburantin që përdoret për furnizimin e këtyre mjeteve lundruese në këto zona.

Duke qenë se parashikohet një furnizim i mjeteve lundruese për argëtim me karburant, mesatarisht në vlerën rreth 18 mijë ton në vit ose thënë ndryshe rreth 21 milion litra karburant

në vit, atëherë nga vendosja e taksës në vlerën 40 lekë për litër parashikohet një efekt financiar pozitiv në të ardhurat e shtetit me rreth +900 milion lekë në vit, ose 0,05 % e PBB-së.

- d. Vendosja e një takse prej 100 lek/kg për importimin ose prodhimin e qumështit pluhur. Ky propozim, konkretisht synon që të incentivojë prodhimin dhe tregtimin në vend të qumështit, me synim mbështetjen e fermerëve vendas. Kjo, duke marrë në konsideratë dhe faktin se, sektori i qumështit konsiderohet si sektor me përparësi nisur nga potenciali për zëvendësimin e importit.**

Duke parashikuar një import mesatar prej rreth 1.000 ton qumësht pluhur në vit, referuar të dhënave të vitit 2019 dhe gjashtëmujorit të parë të vitit 2021, me vendosjen e taksës 100 lek/kg parashikohet një efekt financiar pozitiv në të ardhurat e shtetit me + 100 milion lekë në vit.

- e. Taksa për kategorinë “baste sportive” në ligjin e lojrave të fatit.**

Kategoria e lojrave të fatit “baste sportive” u abrogua nga ligji në fund të vitit 2018. Shkaqet e abrogimit të kësaj kategorie lidheshin me disa pasoja të krijuara nga numuri shumë i lartë i pikave të basteve në cdo qytet dhe pasojat sociale të krijuara nga një kategori e caktuar lojtarësh. Në vitet në vijim, pas mbylljes së pikave të basteve, vihet re se vazhdon vendosja e basteve por duke përdorur sisteme online të lojrave të kësaj kategorie. Indetifikimi dhe ndjekja e tyre është shumë e vështirë, ndërkohë që kjo veprimtari ilegale realizon të ardhura jashtë sistemit tatimor. Për këto arsye, do të jetë më oportune që të formalizohen në ligj bastet sportive online, duke vendosur rregulla shumë të forta licensimi dhe mbikqyrje, me qëllim që të deklarohet e ardhura e krijuar dhe të paguhet detyrimet tatimore, për të cilat vlerësohet që të ardhurat në vitet në vijim të rriten me 0,25 të PBB-së.

Tatimet Direkte - Tatimet mbi të ardhurat


Tatimet mbi të ardhurat e personave juridikë dhe individëve (tatimi mbi fitimin korporativ, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, tatimi mbi të ardhurat personale), janë burim i rëndësishëm në të hyrat e buxhetit të shtetit. Në 3 vitet e fundit ato përbëjnë 4,5 % të PBB-së dhe kapin rreth 18 % në strukturën e të ardhurave tatimore gjithsej.

Politika tatimore në 4-5 vitet e ardhshme do synojë ridizenjimin e sistemit të taksimit të të ardhurave individuale dhe ato nga biznesi, analizën e efektivitetit dhe përmbushjes së qëllimeve për të cilat ishin dizenuar incentivat fiskale për tatimet mbi të ardhurat, duke rishikuar me realizëm incentivat pa efekte substanciale në rritjen ekonomike të vendit, si dhe, dizenujimin e një sistemi më të thjeshtë, gjithpërfshirës dhe me synim zgjerimin e bazës së tatimit në lidhje me tatimin mbi të ardhurat personale.

Tatimet mbi të ardhurat, fitimin dhe fitimet kapitale për individët dhe personat juridikë.

Tatimi mbi të ardhurat-në raport me PBB-në

(Në % të PBB-së)



Grafiku 4: Përqindja e tatimeve direkte krahasuar me vendet e rajonit dhe të BE-së

Sikurse shihet nga Grafiku 4 më lart, vendi ynë arkëton në buxhet tatime direkte mbi të ardhurat e biznesit dhe atyre individuale, 40-50 % më pak se vendet e Bashkimit European. Kjo diferencë jo e vogël e kontributit fiskal të tatimeve direkte mbi të ardhurat në buxhet, lidhet kryesisht me 3 faktorë:

- Tarifat përgjithësisht të ulta tatimore që zbaton Shqipëria krahasuar me vendet e BE-së;
- Përrjashtimet e gjera nga tatimi mbi të ardhurat për bizneset dhe individët;
- Mosraportimi/nenraportimi i të ardhurave dhe fitimeve nga bizneset dhe individët.

1.1.Drejtimet kryesore të reformës së politikave fiskale për tatimet direkte do të jenë:

- Unifikimi i normës tatimore të tatimit mbi fitimin e bizneseve, brenda normave minimale të parashikuara në nismën e BEPS-it (Base Erosion Profit Shifting).
- Analiza e efekteve dhe impaktit real mbi ekonomine, bizneset dhe konsumatorët e incentivave tatimore/tarifave të reduktuara tatimore, të akorduara në periudha të ndryshme, duke adresuar problematikën e krijuar prej tyre. Nëse këto politika stimuluese e kanë realizuar objektivin e tyre, do ndërmerren hapa për heqjen e tarifave të reduktuara preferenciale të tatimit mbi fitimin për industri dhe sektorë specifike
- Zëvendësimi i incentivimit nëpërmjet tarifave të reduktuara të tatimit me incentivimin bazuar në kosto të sektorëve prioritarë
- Rishikimi dhe revizionimi i skemës së taksimit të bizneseve me të ardhura të ulta, duke aplikuar skema të thjeshta taksimi me kuotë fikse dhe me % mbi të ardhurat bruto të biznesit

- e. Rishikimi i taksimit të profesioneve të lira dhe atyre të rregulluara. Analiza e ngarkesës fiskale të profesionistëve të punësuar, vetpunësuar apo të inkuorporuar, me qëllim krijimin e kohezionit dhe mënjanimin e diferencimeve të theksuara në taksimin e të ardhurave personale apo biznese, vetëm si rezultat i zgjedhjes së skemave favorizuese që shmangin pagimin e tatimit të ndershëm në raport me të ardhurat e realizuara.
- f. Zgjerimi i bazës së deklarimit të të ardhurave personale globale, duke rritur pragun aktual të detyrimit për deklarim. Krijimi i njësive të specializuara në administratën tatimore, të dedikuara për kontrollin e individëve me të ardhura shumë të larta.
- g. Futja e një skeme taksimi progresiv jo vetëm për të ardhurat nga punësimi, por për të ardhurat globale të individëve.
- h. Përmirësim i progresivitetit në skemën aktuale të taksimit të të ardhurave nga punësimi.
- i. Rritje graduale e pagës minimale për efekt të kontributeve dhe pagës minimale për efekt të tatimit mbi pagën, duke synuar njehësimin e tyre në të ardhmen

a. Unifikimi i normës tatimore të tatimit mbi fitimin për të gjitha bizneset.

Tatimi mbi fitimin dhe tatimi i thjeshtuar mbi fitimin

Sipas skemës aktuale të taksimit, tarifatatimore që aplikohen për taksimin e të ardhurave biznese janë:

- 0 % për tatimpaguesit me të ardhura vjetore 0-14 milion lekë;
- 15 % për tatimpaguesit me të ardhura vjetore mbi 14 milion lekë.

Teorikisht, sistemet që përmbajnë disa norma tatimore, krijojnë hapsira për shmangie dhe është e njohur tendenca e tatimpaguesve për të përfituar nga rregjimet e taksimit me norma më të ulta. Struktura e operatorëve ekonomikë në Shqipëri është e tillë ku pjesa dërrmuese e tatimpaguesve bëjnë pjesë në grupet me të ardhura shumë të ulta apo të ulta:

Numuri total i tatimpaguesve biznese të regjistruara aktive është 123,446 nga të cilët:

- ✓ Tatimpagues me të ardhura 0-5 milion 94,279 ose 76.4% e totalit;
- ✓ Tatimpagues me të ardhura 5-8 milion 4,035 ose 3.3% e totalit;
- ✓ Tatimpagues me të ardhura 8-14 milion 13,948 ose 11.3% e totalit;
- ✓ Tatimpagues me të ardhura mbi 14 milion 11,186 ose 9% e totalit.

Pra 91% e totalit të bizneseve që operojnë në Shqipëri deklarojnë të ardhura deri 14 milion lekë.

Nisur nga panorama e mësipërme, analiza dhe marrja e masave në të ardhmen për përmirësimin e kësaj skeme të taksimit të të ardhurave të biznesit sjell:

- kufizimin e trajtimit të diferencuar brenda regjimit të përgjithshëm të tatimeve direkte;
- parandalimin e krijimit të hapësirave për abuzime me deklarimin;

- ofrimin e neutralitetit nga këndvështrimi i ngarkesës tatimore për të gjitha format e biznesit;
- uljen e kostove të përmbushjes për tatimpaguesit e vegjël;
- reduktimin e kostove të administrimit dhe kontrollit të deklarave të tatimpaguesve të vegjël nga administrata tatimore.

Hapat që do të ndërmerren janë të fokusuar në

- ✓ Tejkalimin e situatës së vështirë ekonomike si rezultat i Covid-19

Pandemia globale e Covid-19 ka krijuar probleme serioze ekonomike jo vetëm në Shqipëri por edhe në kontekstin rajonal dhe global. Në vitin 2020 pati rënie të konsumit dhe kërkesës, e cila është shoqëruar me ulje të prodhimit, të qarkullimit, mbyllje të vendeve të punës dhe reduktim të kapaciteteve. Kjo situatë ka vështirësuar veprimtarinë e njësive ekonomike, duke sjellë mungesë likuiditeti dhe mundësi për përballimin e shpenzimeve. Sektorë dhe industri të caktuara si turizmi, fasoni, etj, kanë patur dëme serioze. Të ndodhur në këtë situatë dhe bazuar në veprimet e ndërmarra nga vendet e tjera të prekura, qeveria shqiptare ka tentuar krahas masave të tjera edhe ofrimin e stimuljeve fiskalë të domosdoshëm për tejkalimin e situatës, duke operuar në disa drejtime:

- ❖ Nxitjen e konsumit duke subvencionuar nga buxheti i shtetit pagat e kompanive private që larguan punonjësit, pagat e kompanive që kanë ndërprerë veprimtarinë me vendim të Qeverisë dhe pagat e kompanive private që reduktuan ndjeshëm aktivitetin;
- ❖ Mbështetjen e cash floë të ndërmarrjeve duke shtyrë dhe anuluar pagesat e tatimeve direkte mbi të ardhurat gjatë vitit 2020;
- ❖ Mbështetjen e kompanive private me kredi të garantuara nga shteti.

Pavarësisht stimuljeve fiskalë të akorduara nga Qeveria, vazhdimi i pasojave të pandemisë kërkon stimuj të tjerë fiskalë, sidomos për bizneset e vogla të cilat kanë pësuar goditjen më të madhe dhe njëkohësisht nuk disponojnë kapitalet e nevojshme për përballimin e situatës.

Ndodhur në këto rrethana, qeveria ka parë si oportune ofrimin e stimullit fiskal për bizneset e vogla me të ardhura vjetore 5-14 milion lekë, duke i përjashtuar ato nga tatimi mbi të ardhurat e biznesit. Pra norma e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe tatimit mbi fitimin për tatimpaguesit me të ardhura vjetore deri 14 milion lekë është 0%. Nga ky stimul fiskal kanë përfituar 17,983 biznese të vogla, krahas 94,279 subjekteve të vogla me të ardhura 0-5 milion që e kanë patur 0% normën tatimore.

Me tejkalimin e pasojave të krizës së shkaktuar nga Covid-19, do krijohen mundësi për rishikimin e politikave lehtësuese, por gjithmonë me synimin e qartë të thjeshtësisë së sistemit tatimor, neutralitetit të tij dhe shmangies së abuzimeve duke shfrytëzuar shkallët e diferencuara të tatimit.

Sistemi tatimor që do miratohet, duhet të marrë në konsideratë pengimin e dizenjimit nga ana e bizneseve të skemave të taksimit që bazohen në shfrytëzimin jo të ndershëm të shkallës zero të tatimit, apo shkallëve të reduktuara të tij. Për bizneset e vogla është më oportune dizenjimi i

një sistemi të thjeshtë taksimi mbi të ardhurat bruto, duke taksuar bizneset shumë të vogla me kuotë fikse tatimi, por duke përdorur një shkallë të pranueshme të tatimit për ta.

b. Rishikimi i efektivitetit të përjashtimeve, tarifave të reduktuara dhe atyre preferenciale të tatimit mbi fitimin për industri dhe sektorë specifikë

Në të ardhmen do synohet që të ketë unifikim në një normë të vetme standarte të tatimit mbi fitimin korporativ. Tatimi mbi fitimin të funksionojë me një normë të vetme tatimore, për të gjithë tatimpaguesit pa asnjë diferencim sektorial. Kjo do t'u mundësojë investitorëve thjeshtësi, parashikueshmëri dhe siguri, duke kufizuar mundësinë për politika shtrembëruese dhe diskrete.

Tarifat preferenciale të tatimit mbi fitimin korporativ në fuqi

a. Subjektet e përjashtuara nga tatimi:

- shtëpitë filmike të prodhimit kinematografik, të licencuara dhe të subvencionuara nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë.”
- fondet vullnetare të pensionit, të administruara nga shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar.
- strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”. Përjashtimi aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për ato struktura, të cilat përfitojnë statusin special deri në dhjetor 2024. Efektet e përjashtimit fillojnë në momentin e fillimit të veprimtarisë ekonomike të strukturës akomoduese, por jo më vonë se 3 vjet nga marrja e statusit special.

Për shtëpitë filmike të prodhimit kinematografik, bëhet fjalë për ato kompani të cilat subvencionohen nga qendra e kinematografisë pra nga fonde të buxhetit të shtetit. Incentiva mund të hiqet në terma afatmesëm.

Në lidhje me fondet vullnetare të pensionit, nuk duhet hequr përjashtimi nga tatimi, pasi sipas ligjit në fuqi taksohen të ardhurat nga pensioni, kur përfitohen të ardhurat si pension. Nëse këto fonde do taksohen në momentin e investimit (duke hequr incentivën-tatimin 0 %), duhet të përjashtohen në momentin e përfitimeve, sikurse zbatohet përjashtimi edhe nga skema e detyrueshme.

Incentiva 0% tatim për strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, ka synuar thithjen e investimeve të huaja serioze në industrinë e turizmit, duke e parë këtë industri si faktor shumë të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë shqiptare, rritjen e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale të nevojshme për turizmin dhe dhe rritjen e shërbimeve dhe të punësimit.

b. Subjekte që përfitojnë tarifa të reduktuara të tatimit mbi fitimin

- ✓ Normë e reduktuar 5% për personat juridikë, të cilët ushtrojnë aktivitet në **prodhimin/zhvillimin e software-ve.**

Kjo incentivë u argumentua me:

- nxitjen e shërbimeve të eksportit të produkteve IT (prodhim software, bazë të dhënash, mirëmbajtje remotely, etj) nga kompanitë shqiptare të IT, për klientë jashtë territorit shqiptar;
- numrin e lartë të specialistëve të diplomuar në IT, që mund të punojnë në kompani shqiptare për klientë të huaj dhe që duhet të stimulohen me nivel të lartë page me qëllim mos rrjedhjen e trurit jashtë vendit. Pra u synua mbajtja e specialistëve të kualifikuar në vend, duke i stimuluar me paga më të larta, ndërkohë që shteti reduktoi për këto kompani barrën fiskale të tatimit mbi fitimin nga 15% në 5%.

Treguesit financiarë të vitit 2020 tregojnë se përfitimi i kompanive të IT e lidhur me këtë tarifë të reduktuar tatimore ka qënë 245 milion lekë. Kjo incentivë do rishikohet në lidhje me efektin e saj në rritjen e shërbimeve dhe punësim, me qëllim përcaktimin e afatit të aplikimit të saj dhe aplikimit të normës standarde të tatimit.

- ✓ Normë e reduktuar 5% për **shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor**

Incentiva ka synuar kooperimin e fermerëve në fushën e bujqësisë. Incentiva hyri në fuqi në vitin 2019 dhe nuk ka gjasa që për këtë periudhë të shkurtër të ketë prodhuar ndonjë rezultat pozitiv në lidhje me qëllimin e saj. Nuk ka pasur efekte negative në buxhet, apo humbje të ardhurash tatimore, pasi numuri i operatorëve në këtë fushë ka qënë i papërfillshëm si para, ashtu edhe pas miratimit të incentivës. Mund të rishikohet si incentivë në një periudhë afatmesme.

- ✓ Norme e reduktuar 5 % për subjektet, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “**agroturizëm**”, Kjo shkallë aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për personat juridikë që përfitojnë statusin “subjekt i certifikuar agroturizmi”, deri më 31 dhjetor 2021.

Incentiva ka synuar nxitjen e investimeve në agroturizëm. Është miratuar me efekt nga janari 2019. Për shkak të rëndësisë që ka sektori i turizmit në Shqipëri dhe me qëllim nxitjen e investimeve të tilla në zonat rurale të vendit, incentiva duhet të vazhdojë sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në ligj.

- ✓ Norme e reduktuar 5 % për subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike në **industrinë automotive.**

Incentiva ka synuar thithjen e investimeve dhe kapitalit të huaj. Eshtë miratuar me efekt nga janari 2020 dhe ende nuk ka tregues të matshëm të efekteve të saj.

c. Zëvendësimi i incentivimit nëpërmjet tarifave të reduktuara të tatimit me incentivimin bazuar në kosto të sektorëve prioritarë

Në 5 vitet në vijim do të synohet kalimi nga stimujt e bazuar në tarifatatimore të reduktuara, në stimujt e bazuar tek shpenzimet. Do të merren në konsideratë incentivat tatimore në fushën e kërkim zhvillimit (R&D), nëpërmjet njohjes së shumëfishtë të tyre si shpenzime biznesi, si një formë stimulimi ndaj kompanive, për përfitimet shoqërore që vijnë nga inovacioni. Ndërkohë që stimujt tatimore të R&D mund të jenë efektivë në stimulimin e investimeve të biznesit në kërkim-zhvillim, hartimi, administrimi dhe mënyra e përfitimit të incentivës është thelbësor për efektivitetin e këtyre masave.

d. Revizionimi i skemës së taksimit të bizneseve me të ardhura të ulta, duke aplikuar skema të thjeshta taksimi me kuotë fikse dhe me % mbi të ardhurat bruto të biznesit.

Sistemi aktual i taksimit për bizneset e vogla në vendin tonë, është kompleks dhe kërkon mbajtjen e një niveli të caktuar regjistrimesh, i cili mund të mos jetë shumë i nevojshëm për këtë kategori biznesesh. Ky konstatim vjen edhe nga Raportet e FMN-së, ndërkohë që, sugjeron se duhet të rishikohet niveli i të ardhurave për përcaktimin e normës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.

Në këtë kuadër, në të ardhmen, pas vitit 2026 do të duhet të ndërmerren ndryshime thelbësore që të mund të aplikohen masa të tilla si:

- Bizneset shumë të vogla të trajtohen me një skemë të thjeshtë, me prag të ulët të të ardhurave dhe me kërkesa më të thjeshtuara të mbajtjes së regjistrimeve. Në këtë kuadër për bizneset me të ardhura deri në 1 milion lekë, mund të aplikohet pagesë vjetore fikse tatimi (psh 25.000 lekë).
- Për tatimpaguesit, të cilët aktualisht janë të përjashtuar nga tatimi nëse kanë të ardhura deri 14 milion lekë në vit, nuk paguajnë tatim mbi fitimin neto, sugjerohet që për tatimpaguesit me të ardhura deri 8 milion lekë në vit, të prezantohet një regjim tatimor i thjeshtuar bazuar në aplikimin e një tarife 2-4% mbi të ardhurat bruto dhe jo të taksohen mbi fitimin neto.

e. Trajtimi fiskal i profesioneve të lira dhe atyre të rregulluara.

Në sistemin aktual tatimor, profesionistët kanë detyrimin e regjistrimit si subjekte tatimore, dhe shumica e tyre përfshihen në fashën e subjekteve me të ardhura deri 14 milion lekë në vit, pra që gëzojnë të drejtën e tarifës tatimore 0 % (te ardhurat e tyre janë të përjashtuara nga pagesa e tatimit). Ky trajtim fiskal ka krijuar diferencime shume të mëdha në skemat e taksimit ndërmjet profesionistëve të vetpunësuar dhe profesionistëve të punësuar, duke shkelur parimin

e barazisë në taksim. Në këtë kuadër do të rishikohet mënyra e trajtimit të profesioneve të lira dhe ose të licensuara (profesionistëve), si mëposhtë:

- Përfshirja e profesionistëve të vetëpunësuar në sistemin e tatimit mbi të ardhurat personale. Individët e vetëpunësuar që veprojnë brenda profesioneve të lira dhe/ose të licensuara, duhet të futen në regjimin e tatimit mbi të ardhurat personale. Kjo do të ndihmojë në rivendosjen e neutralitetit ndërmjet një grupi tatimpaguesish që janë praktikisht të dallueshëm nga të punësuarit përsa i përket të ardhurave të tyre të cilat në thelb janë përfitime nga individë të specializuar, të aftë, të kualifikuar dhe të certifikuar/licencuar, përfitime këto të cilat ndryshe konsiderohen si ekuivalente me pagat (pas zbritjes së disa shpenzimeve të domosdoshme).
- Individët e vetëpunësuar, për qëllime të të ardhurave të tatueshme nën tatimin mbi të ardhurat personale, mund t'u lejohe të zbrisin një shpenzim maksimal të vlerësuar, për shembull, 10-20 përqind nga të ardhurat. Skema e taksimit të të ardhurave personale të tyre, pasi të jetë zbritur një shumë shpenzimesh të lejueshme, mund të jetë:
 - Sipas skemës së taksimit të të punësuarve;
 - Me % mbi të ardhurat neto pas zbritjes së një shumë shpenzimesh të supozuara.

Ky ndryshim mund të aplikohet duke filluar nga viti 2023. Ky ndryshim do shoqërohet edhe me heqjen e pragut 2 milion lekë të deklarimit të DIVA-s.

f. Zgjerimi i bazës së deklarimit të të ardhurave personale, duke hequr pragun përjashtues 2 milion lekë në vit.

Zgjerimi i bazës së deklarimit të të ardhurave personale globale, duke hequr pragun përjashtues 2 milion lekë në vit është masë pozitive për nxitjen e përmbushjes vullnetare dhe deklarimin e të ardhurave. Heqja e kufirit të deklarimit 2 milion lekë duhet të marrë në konsideratë:

- ✓ kapacitetet teknike për pranimin dhe përpunimin e shumëfishit të deklaratave që përpunohen aktualisht;
- ✓ nevojat shtesë në burime njerëzore për mbikqyrje dhe auditim;
- ✓ kostot e pajtimit për qytetarët;
- ✓ efektet reale pozitive në rritjen e të ardhurave që do të ketë një ndërmarrje e tillë në kushtet kur për pjesën dërrmuese të të ardhurave tatimi mbahet në burim nga paguesi i të ardhurave.

g. Njehsimi i pagës minimale për efekt të kontributeve me pagën minimale për efekt të tatimit mbi pagën, përmirësimi i progresivitetit në skemën aktuale të taksimit të të ardhurave nga punësimi si dhe futja e një skeme taksimi progresiv jo vetëm për të ardhurat nga punësimi, por për të ardhurat globale të individëve.

Taksat e punës të cilat përfshijnë tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, përbëjnë një burim të rëndësishëm tatimor në Shqipëri

dhe ato mund të kenë një impakt të rëndësishëm në aktivitetin ekonomik, dhe efencën e tregut të punës.

Tatimi mbi të ardhurat personale nga punësimi tatohet me normë progresive sipas fashave:

- ✓ 0 - 30,000 lekë në muaj të ardhurat nga paga janë të përjashtuara;
- ✓ 30,001 – 150,000 lekë në muaj, 13% të shumës mbi 30,000 lekë;
- ✓ Mbi 150,001 lekë në muaj, 15,500 lekë tatim +23% të shumës së pagës mbi 150,000 lekë.

Në terma afatshkurtër, duke filluar nga viti 2022 synohet

- ✓ Ulja e ngarkesës tatimore për pagat e ulta duke rritur pragun përjashtues nga 30,000 lekë në 40,000 lekë në muaj;
- ✓ Uljen e tatimit me 50 % për pagat mujore në segmentin 40,000 – 50,000 lekë në muaj;
- ✓ Rritjen e aplikimit të tarifës maksimale të tatimit 23% nga 150,001 lekë në 200,000 lekë në muaj.

Për qëllime të bazës së llogaritjes për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore aplikohet një pagë minimale në masën 30,000 lekë në muaj. Paga minimale rishikohet në rritje në mënyrë periodike, zakonisht çdo dy apo tre vjet. Me përqindjen e rritjes së pagës minimale, rritet edhe paga maksimale për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore. Ndërkohë, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shëndetësore, nuk ka kufi të sipërm të pagës.

Në terma afatmesëm, sistemi aktual i taksimit të punës ka nevojë për ndërhyrje me qëllim reduktimin e ndërlikimeve që shkaktojnë disa baza tatimesh. Po kështu duhet të rishikohet edhe kontributi i të punësuarve në bujqësi, duke synuar që të unifikohet niveli i kontributit minimal të personave të vetëpunësuar në bujqësi, me kontributin minimal që aplikohet për skemën e përgjithshme për të vetëpunësuarit.

Taksat Lokale

Në vitin 2018 u miratuan ndryshimet në skemën e taksimit të pasurive të paluajtshme, ndërtesa, duke kaluar nga taksa me kuotë fikse për m², në taksën ad valorem pra me përqindje mbi vlerën e pasurisë së paluajtshme-ndërtesë. Kjo reformë u shoqërua me krijimin e Kadastrës Fiskale dhe të Regjistrit të pasurive të paluajtshme ku evidentohen pasuritë e paluajtshme, pronarët, vendndodhja, vlera e pronës dhe të dhëna të tjera. Miratimi i ligjit të ri u shoqërua me vendosjen e disa përjashtimeve nga pagesa e taksës. Nga vlerësimet paraprake vërehet se disa përjashtime duhet të eliminohen, si dhe ka hapsirë që të mund të rritet edhe norma e taksës së pronës. Në këtë kuadër në terma afatmesëm do ndërmerren hapat e mëposhtëm:

- Rishikimi i përjashtimeve nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme. Duke qenë se të ardhurat nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme përbën burim kryesor të të ardhurave të pushtetit vendor, është e nevojshme që përjashtimet të mbahen në nivele minimale dhe

ndërkohë, lehtësirat tatimore për grupet vulnerabël duhet të ofrohen nëpërmjet mekanizmave dhe formave të tjera.

- Rishikimi në rritje i tarifës së taksës. Duhet të dizajnohet një rritje progresive e normës së taksës mbi pasuritë e paluajtshme ndërtesa. Aktualisht, taksa mbi pasuritë e paluajtshme në Shqipëri kontribon në masën 0.3% të PBB-së, ndërkohë që të ardhurat mesatare që gjenerohen nga taksa e pronës në vendet e tjera të rajonit janë rreth 0.8% e PBB-së.

Taksimi ndërkombëtar

Përpjekjet e nevojshme për të ruajtur dhe ushtruar të drejtat e tatimit në burim (pa rrezikuar konkurrencën tatimore të Shqipërisë), duke konsoliduar në këtë mënyrë bazën e tatimit në Shqipëri, mbetet një çështje e rëndësishme për financat publike të vendit tonë. Për këtë qëllim do hartohet një politikë aktive në fushën e marrëveshjeve të taksimit të dyfishtë, përtej Multilateral Instrument, të vendosur nën kontrollin e Ministrisë përgjegjëse për financat, me qëllim që Shqipëria të sigurojë përfitime neto nga këto marrëveshje tatimore. Rregullat mbi burimin në Shqipëri të të ardhurave kanë nevojë për rishikim, veçanërisht për të sqaruar faktorët që lidhin burimin me Shqipërinë.

- do dizajnohet dhe zhvillohet një politikë e qartë dhe e ekuilibruar në lidhje me vendimarrjen në lidhje me marrëveshjet tatimore.
- do synohet rinegociimi i disa marrëveshjeve me qëllim ndryshimin e disa klauzolave të veçanta me qëllim mbrojtjen e së drejtës së taksimit në vendin e burimit, bazuar në Modelin e Kombeve të Bashkuara i cili favorizon vendet e burimit sikurse është Shqipëria.

PLANI OPERACIONAL I VEPRIMIT 2022-2026 NE LIDHJE ME POLITIKAT TATIMORE

Në tabelën më poshtë paraqiten masat që do ndërmerren në periudhën 2022-2026 në fushën e ndryshimeve në politikat fiskale. Këto masa janë paraqitur gjithashtu në shtojcën 1 dhe shtojcën 1.1 të shoqëruara me efektet financiare, përkatësisht në % të PBB-së dhe në vlerë.

Nga implementimi i ndryshimeve në politikat tatimore, synohet që në fund të periudhës së implementimit të Strategjisë, të ardhurat tatimore ndaj PBB-së të rriten 1.31 % e PBB-së.

Nr	MASAT	Në % ndaj PBB				
		2022	2023	2024	2025	2026
	Produkti i Brendshëm Bruto	1,867,351	1,964,760	2,070,852	2,183,000	2,299,000
I	TATIMET INDIREKTE					
1	Tatimi mbi vlerën e shtuar					
a	Furnizimi i shërbimeve shëndetsore që furnizohen nga sektori privat			0.1	0.1	0.1
b	Furnizimi i shërbimeve të edukimit që furnizohen nga sektori privat			0.03	0.03	0.03
d	Furnizimi i shërbimeve financiare nga bankat/institucionet financiare			0.1	0.1	0.1
e	Furnizimi i shërbimeve të sigurimit					0.01
f	TVSH për shitjen e parë të banesave të reja rezidenciale.					0.02
g	Heqja e tarifës së reduktuar 6 % për shërbimet e akomodimit, reklama në mediat audiovizive, etj					0.02
k	Rishikimi i pragut të regjistrimit në TVSH					0.1
l	Skema e kompensimit të fermerit	0.04	0.04	0.04	0.04	0.04
m	TVSH e inuteve bujqësore	0.05	0.05	0.05	0.05	0.05
n	Rritja e kufirit të përjashtimit nga TVSH-ja në import për makineritë dhe pajisjet për investime.	0.02	0.02	0.02	0.02	0.02
	TOTALI I EFEKTI T VJETOR NE TE ARDHURA NGA TVSH	0.11	0.11	0.34	0.34	0.49
2	Akciza					
a	Tarifë e unifikuar akcize për produktet birrë dhe verë, duke eliminuar diferencat në nivelin e akcizës ndërmjet prodhuesve të vegjël dhe prodhuesve të mëdhenj	0.01	0.02	0.02	0.02	0.02
b	Futja në ligjin e akcizës të detyrimit për indeksimin automatik të tarifave specifike të akcizës së mallrave.	0.03	0.03	0.03	0.03	0.03
c	Programimi për rritjen vjetore të akcizës së cigares	0.04	0.04	0.05	0.05	0.04
d	Karburanti nga Zonat e Lira	0.05	0.05	0.05	0.02	0.02
e	Unifikimi i akcizës së gazit të lëngshëm	0.04	0.06	0.06	0.06	0.07
f	Heqja e perjashtimeve te tjera nga akciza				0.25	0.25
	TOTALI I EFEKTI T VJETOR NE TE ARDHURA NGA AKCIZA	0.17	0.2	0.21	0.43	0.43
II	TATIMET DIREKTE					
1	Tatimet Direkte mbi te Ardhurat					
a	Unifikimi i normës tatimore të tatimit mbi fitimin për të gjitha bizneset në					0.02
b	Shfuqizim i përjashtimeve, tarifave të reduktuara, tarifave preferenciale të tatimit mbi fitimin për industri dhe sektorë specifikë		0.01	0.02	0.01	0.02
c	Rishikimi i skemës së taksimit të bizneseve te vogla.					0.1
d	Skema e taksimit te profesioneve të lira		0.02	0.03	0.03	0.03
e	Tarifë progresive tatimi për DIVA. Rishikimi i pragut të deklarimit të DIVA.			0.02	0.02	0.02
f	Progresivitetit brenda regjimit të tatimit mbi të ardhurat personale.	-0.04	-0.08	-0.08	-0.08	-0.08
	TOTALI I EFEKTI T VJETOR NE TE ARDHURA NGA TATIMI MBI TE	-0.04	-0.05	-0.01	-0.02	0.11
III	Taksat dhe Tarifat Kombëtare dhe Lokale					
	Taksat dhe Tarifat Kombëtare					
a	Zgjerimi i kategorive të Lojrave të Fatit	0.15	0.25	0.25	0.25	0.25
	TOTALI I EFEKTI T VJETOR NE TE ARDHURA NGA TAKSAT NACIONALE	0.15	0.25	0.25	0.25	0.25
	Taksat Lokale					
a	Rishikimi i përjashtimeve nga taksat mbi pasuritë e paluajtshme					0.01
b	Rishikimi në rritje i tarifës së taksës					0.02
	TOTALI I EFEKTI T VJETOR NE TE ARDHURA NGA TAKSAT LOKALE					0.03
	TOTALI MESATAR I EFEKTEVE NE NJE VIT	0.39	0.51	0.79	1	1.31

Tabela 3 Politikat fiskale të parashikuara 2022-2026 dhe efektet e tyre financiare në një vit

Politikat fiskale të synuara sipas viteve të Strategjisë:

Në vitin 2022 rishikohen:

- politikat për reduktimin e barrës fiskale të tatimit mbi pagat për të punësuarit me paga të ulta, duke ulur pragun përjashtues, si dhe zbutjen e ngarkesës së taksimit me tarifën maksimale të segmentit të pagave 150-200 mijë lekë;
- politikat përjashtuese dhe të tarifave të reduktuara të TVSH-së;
- politikat përjashtuese dhe të tarifave të reduktuara në akciza;
- politikat për rritjen e ngarkesës fiskale për duhanet.

Në vitin 2023 rishikohen:

- politikat fiskale përjashtuese dhe me tarifa të reduktuara të tatimit mbi fitimin korporativ;
- politikat fiskale të taksimit të profesioneve të lira, profesioneve të rregulluara dhe furnizuesve me shërbime.

Në vitin 2024 rishikohen:

- politikat fiskale përjashtuese nga TVSH të furnizimit të disa lloj shërbimeve nga sektori privat;
- politikat fiskale të taksimit progresiv dhe shtrirjen e progresivitetit jo vetëm mbi pagat, por mbi të ardhurat globale të individëve me të ardhura të larta dhe nga shumë burime.

Në vitin 2025 rishikohen:

- politikat fiskale në lidhje me taksat ambientale;
- politikat fiskale në lidhje me unifikimin e nivelit të akcizës për disa produkte akcize.

Në vitin 2026 rishikohen:

- politikat fiskale në lidhje me tarifat tatimore dhe përjashtimet nga tatimi mbi pasurinë;
- politikat fiskale në lidhje me taksimin e bizneseve të vogla;
- politikat fiskale në lidhje me unifikimin e shkallës së tatimit mbi fitimin korporativ;
- politikat fiskale në lidhje me pragun e TVSH-së.

KREU III: PËRMIRËSIMET NË ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE TATIMORE DHE DOGANORE

Krahas politikave fiskale, mirëadministrimi tatimor dhe doganor është një kontribues i rëndësishëm në mobilizimin dhe rritjen e të ardhurave tatimore. Në këtë kre paraqiten prioritet kryesore të administrimit të të ardhurave, që do të jenë pjesë e kësaj strategjie gjatë një periudhë pesëvjeçare. Strategjia do të fokusohet në problematikat kryesore të pajtueshmërisë tatimore dhe parashikon masa konkrete për të adresuar sektorët me risk si dhe krijimin e kapaciteteve institucionale.

Nga përmirësimet në administrimin e të ardhurave tatimore parashikohet rritje e të ardhurave në fund të periudhës 5 vjeçare me 1.24% të PBB-së, nga e cila 0,92% e PBB-së rezulton nga përmirësimet në administrimin e tatimeve të brendshme dhe 0.32% e PBB-së rezulton nga përmirësimet në administrimin e të ardhurave doganore.

Administrata Tatimore

Prioritetet e mirëadministrimit tatimor të administratës tatimore që parashikohet të kontribuojnë në uljen e evazionit dhe rritjen e të ardhurave, për periudhën pesëvjeçare janë:

- 1. Zvogëlimi i hendekut të përmbushjes në lidhje me TVSH;**
- 2. Reduktimi i punës së padeklaruar, nëndeklarimit dhe ulja e pagesave me para nëdorë në ekonomi;**
- 3. Hetimi i pasurisë së pajustificuar;**
- 4. Ulja e evazionit tatimor;**
- 5. Reduktimi i kostove të përmbushjes dhe rritja e sigurisë tatimore dhe besimit të administratës tatimore;**
- 6. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga Administrata Tatimore (AT) nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve institucionale të administratës tatimore.**

Nga zbatimi i masave dhe aktiviteteve të parashikuara për secilin prioritet pritet të gjenerohen të ardhura shtesë rreth 0.92% të PBB ose 20.05 miliardë lekë në një periudhë 5 vjeçare. Në shtojcën 2 dhe shtojcën 2.1 paraqitet ndikimi financiar i detajuar shprehur përkatësisht në % të PBB-së dhe në vlerë të Administrimit Tatimor të parashikuara gjatë periudhës 2022-2026.

Në Planet e Veprimit bashkëlidhur kësaj Strategjie janë përcaktuar afatet kohore, indikatorët dhe produktet nga secila masë dhe aktivitet. Zbatimi i masave të disa prioriteve kërkon nevojshmërinë e fondeve buxhetore dhe asistencë teknike nga donatorë të huaj. Për këtë arsye, kjo Strategji vlerësohet edhe si një dokument bazë për përthithjen e asistencës së huaj në luftën ndaj informalitetit dhe rritjen e përputhshmërisë.

Anketimet në baza 6 mujore nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve do të shërbejnë si një instrument monitorimi të rezultateve të këtyre reformave në ndryshimin e perceptimit të biznesit dhe rritjes së përputhshmërisë.

Gjatë periudhës pesëvjeçare 2022-2026 janë parashikuara 7 prioritetet të cilat do të ndërmerren nga administrata tatimore dhe doganore me synim uljen e informalitetit.

Indikatorët:	Objektivi	2022	2023	2024	2025	2026
Prioriteti I : Zvogëlimi i hendekut të përmbushjes në TVSH	Rritja e të ardhurave nga TVSH me rreth 0.18% e PPB;	0.12%	0.24%	0.37%	0.51%	0.64%
Prioriteti II: Reduktimi i punës së padeklaruar dhe nëndeklarimit dhe ekonomisë cash	Ulja me 15% e punës së padeklaruar, rritja me 12% e deklarimit vullnetar të pagës dhe qarkullimi i parasë kesh të ulet në 10% të totalit të parasë së qarkulluar;	0.06%	0.08%	0.18%	0.22%	0.28%
Prioriteti III: Tatimi i cdo pasurie të pajustificuar brenda dhe jashtë vendit	Deklarimi vullnetar i asetëve dhe ngritja e bazës ligjore dhe kapaciteteve për hetimin e pasurisë së pashpjeguar;	Nuk mund të vlerësohet				
Prioriteti IV: Zvogëlimi i shmangies së taksave	Krijimi i instrumentave të duhur për të investiguar rastet e shmangieve tatimore;	Nuk mund të vlerësohet				
Prioriteti V. Reduktimi i kostove të përmbushjes dhe rritja e sigurisë tatimore dhe besimit të administratës tatimore	Ulja e kostove të pajtueshmërisë dhe rritjen e sigurisë për tatimpaguesit;	Nuk mund të vlerësohet				
Prioriteti VI Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga Administrata Tatimore nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve institucionale të administratës tatimore.		Nuk mund të vlerësohet				
Total		0.17%	0.32%	0.55%	0.73%	0.92%

Tabela 4 Rritja e të ardhurave në përqindje të PBB-së, 2022- 2026

Prioriteti I : Zvogëlimi i hendekut të përmbushjes në TVSH

Objektivi

Sipas studimeve të bëra nga FMN, hendeku në TVSH në Shqipëri është 28% e PPB në vitin 2015. Ndërsa nënraportimi i tvsh-së është fenomen i gjerë në ekonomi, sektorët me ndikim negativ më të madh janë ndërtimi, tregtia dhe shërbimet.

Objektivi është që në një periudhë 5 vjeçare të zvogëlohet hendeku i TVSH-së me 0.64% të PPB. Ky objektivi synohet të arrihet nga rezultatet pozitive që do të sjellë projekti i fiskalizimit i kombinuar kjo me masa të tjera që do të ndërmerren në sektorët me më risk për TVSH-në si dhe zbatimi i skemave të testuara ndërkombëtare për minimizimin e skemave të mashtrimit tatimor me TVSH-në sikurse është skema e autofaturimit. Në tabelën 5 pasqyrohen të ardhurat shtesë në % të PBB nga prioriteti I. Këto të ardhura si % e PBB pasqyrohen në mënyrë kumulative.

Prioriteti 1 : Zvogëlimi i hendekut të përmbushjes në TVSH	Objektivi	2022	2023	2024	2025	2026
	Rritja e të ardhurave nga TVSH me rreth 1% e PPB	0.12%	0.24%	0.37%	0.51%	0.64%

Tabela 5 Prioritetit I - Rritja e të ardhurave në % të PBB-së

Për realizimin e këtij prioriteti, do të ndërmerren masat e mëposhtme:

Afatshkurtra (2022-2023)
✓ Masa 1: Maksimizimi i të ardhurave nga fiskalizimi duke siguruar strukturat dhe sistemet e duhura për monitorimin dhe zbatimin.
✓
Afatmesme(2024-2026)
✓ Masa 2: Për sektorët e tjerë të identifikuar me risk, hartimi dhe zbatimi i një vargu projektsh me fokus të përmirësimit të përmbushjes, duke përdorur teknika moderne të MRP-së.
✓ Masa 3: Shënjimi i sektorit të ndërtimit për vëmendje të hershme dhe analizimi i mundësisë të futjes së regjimit me “autofaturim” për të parandaluar humbjet tatimore në zinxhirin e furnizimit të nënkontraktorëve.
✓ Masa 4: Ngritja e masave shtesë mbrojtëse kundër mashtrimit në TVSH, përfshirë edhe përgjegjësinë “solidare dhe individuale” për TVSH-në. dhe masat për autofaturim për mallra të caktuara që kanë më shumë gjasa të jenë pre e mashtrimit.

Rezultatet e Prioritetit

Rezultatet që priten të merren nga ky prioritet janë:

1. Përdorimi i teknologjisë së informacionit, përpunimi i të dhënave dhe menaxhimi i riskut;
2. Rritja e përputhshmërisë së tatimpaguesve;
3. Rritja e kapaciteteve inteligjente për gjurmimin e evazionit dhe shmangies;

4. Analizimi për përfshirjen e skemës së autofaturimit për disa shërbime e mallra për të shmangur zbatimin e skemave të mashtrimit;
5. Regjistri i Aseteve të tatimpaguesve.

Indikatorët:

- 1) Rritja e të ardhurave nga TVSH për të gjithë sektorët e ekonomisë;
- 2) Rritja e të ardhurave nga TVSH në sektorin e ndërtimit;
- 3) Koha e kontrollit të subjekteve;
- 4) Rritja e qarkullimit mbi 3% në baza mujore të sektorëve me risk;
- 5) Minimizimi i skemave të mashtrimit të TVSH-së.

					milion lek	% e PBB-së
	2022	2023	2024	2025	2026	
Prioriteti 1 : Zvogëlimi i hendekut të përmbushjes në TVSH	2,250	4,680	7,600	11,000	14,500	0.64%
Rritja e të ardhurave nga TVSH për të gjithë sektorët e ekonomisë nga fiskalizimi	1,150	2,550	4,100	6,300	8,500	0.37%
Rritja e të ardhurave nga TVSH në sektorin e ndërtimit	550	1,150	1,850	2,600	3,300	0.15%
Rritja e qarkullimit të TVSH-së në sektorët me risk	550	980	1,650	2,100	2,700	0.12%

Tabela 6 Të ardhurat shitesë në vlerë nga ndërmarrja e masave të Prioriteti I

Masa 1: Maksimizimi i të ardhurave nga fiskalizimi duke siguruar strukturat dhe sistemet e duhura për monitorimin dhe zbatimin e tij

Zbatimi i plotë i reformës së fiskalizimit pritet të sjellë rritje të ardhurave nga TVSH rreth 8.50 miliardë lekë ose 0.37% e PPB. Nga 1 janar 2020 ka hyrë në fuqi ligji për faturën dhe monitorimin e sistemeve të qarkullimit, sipas së cilit do të kalohet në deklarim në kohë reale të transaksioneve të biznesve në mënyrë të përshtatshme për kategori biznesi dhe sipas mënyrës së pagesave. Nga data 1 korrik 2021, të gjithë tatimpaguesit dhe pamvarësisht nga mënyra e pagesës, deklarojnë transaksionet në kohë reale.

Transmetimi në kohë reale i faturave dhe e-faturave elektronike ka potencial domethënës për mbledhjen e të ardhurave (veçanërisht për TVSH) bazuar kjo edhe në eksperiencën e vendeve të tjera evropiane që tashmë kanë sisteme të ngjashme. Ndërsa fokusi afatshkurtër është në sfidat praktike të zbatimit të projektit të fiskalizimit për bizneset dhe DPT. Është e rëndësishme që parimet e mëposhtme të drejtojnë qasjen e përgjithshme:

- **Fiskalizimi nuk është një zgjidhje e pavarur ‘magjike’.** Përvoja ndërkombëtare është se ajo mund të sjellë një rritje të përhershme të të ardhurave vetëm nëse është pjesë e një strategjie më të gjerë të përmirësimit të pajtueshmërisë.
- **Monitorimi dhe zbatimi i ndjekjes duhet të jetë i drejtuar nga risku.** Sistemet e filtrimit të duhet të zhvillohen për të siguruar që vëllime të mëdha të të dhënave mbi parregullsitë e dukshme, të jashtme dhe mospërputhjet e faturave janë reduktuar në nivele të menaxhueshme. Kontrollat vijuese të terrenit duhet të kufizohen në rastet e riskut më të lartë, duke marrë parasysh treguesit e tjerë të riskut; "Paralajmërimet e buta" dhe ndërhyrjet me bazë zyre do të jenë të përshtatshme në shumë raste.
- **Fiskalizimi është një mundësi për të kultivuar besim më të madh në sistemin e taksave.** Ndërsa objektivi kryesor është rritja e të ardhurave nga taksat.DPT do të

përdorë mundësinë për të theksuar përfitimet për biznesin, duke përfshirë rimbursimin më të shpejtë të të TVSH-së, kostot e ulëta të pajtueshmërisë në planin afatgjatë nën një sistem të faturës elektronike dhe një sistem më të drejtë tatimor që rezulton nga përmirësimi i përputhshmërisë.

Aktiviteti 1.1. Përditesimi i Modullit të Riskut, në bazë të Projektit të Fiskalizimit dhe nderthurja me modulin aktual.

Aktiviteti 1.2. Finalizimi dhe implementimi i metodologjise së kontrollit në kuadër të Projektit të Fiskalizimit.

Metodologjia e re e kontrollit Tatimor ka për qëllim përcaktimin dhe unifikimin e rregullave dhe procedurave të Administratës Tatimore në zbatimin e proceseve të kontrollit tatimor të fiskalizimit. Kusht për funksionimin me sukses të kësaj metodologjie do të jetë implementimi i raportimit nëpërmjet sistemit BI, moduli i kontrollit tatimor me të gjithë komponentet perberes, trajnimi i inspektoreve të drejtorive pjesmarrese në proces.

E gjithë procedura e kontrollit tatimor e përcaktuar në këtë dokument është baza e rregullave mbi të cilat do të implementohet moduli i Auditit Tatimor i cili do të jetë pjesë përberese e Portalit Qendror. Ky modul do të siguroj nivel të lartë të automatizimit të proceseve të punës.

Aktiviteti 1.3. Rishikimi i Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore dhe i Manualeve për të gjitha Drejtoritë që preken nga ndryshimet që sjell Fiskalizimi

Masa 2. Për sektorët e tjerë të identifikuar me risk, hartimi dhe zbatimi i një vargu projektesh me fokus të përmirësimi i përmbushjes, duke përdorur teknika moderne të MRP-së.

Synimi i kësaj mase është rritja e përputhshmërisë së sektorëve me risk. Zhvillimi i projekteve me fokus të përmirësimin e përmbushjes do të ketë nevojë për ndihmë të mëtijshme për zhvillimin e kapaciteteve - si për teknikat e analizës së të dhënave (për të identifikuar më mirë grupimet e rrezikut brenda vlerësimit të hendekut të TVSH-së), ashtu edhe për hartimin e projektit. Për të pasur ndikim të qëndrueshëm, AT do të hartojë projekt të përmirësimit të përputhshmërisë sektoriale në një mënyrë gjithëpërfshirëse (në vend të miratimit të kontrollve të kufizuar). Për periudhën pesëvjeçare, fokusi i punës së administratës tatimore përpos sektorit të ndërtimit do të jenë, edhe këta sektorë, të evidentuar si sektorë me risk sektori i tregtisë, sektori i hotelërisë, sektori i shërbimeve dhe sektori i hidrokarbureve. Nga marrja e këtyre masave synohet rritja e të ardhurave me 0.15% e PPB ose 3.30 miliardë lekë më shumë.

Për secilin nga këta sektorë, Administrata tatimore do të hartojë Planet Operacionale Sektoriale një vjeçare. Këto plane do monitorohen mbi baza 3 mujore në mënyrë që efikasiteti të jetë i lartë.

Aktiviteti 2.1 Përcaktimi i metodologjisë së teknikave të analizës së të dhënave

Monitorim më i mirë i deklarimeve tatimore, duke ndërthurur dhe kryqëzuar informacion mes strukturave të ndryshme të DPT dhe institucioneve të tjera. Përmirësimi i cilësisë së kontrolleve tatimore nëpërmjet standardizimit të procedurave të kontrollit si dhe automatizimit dhe implementimit në sistemin C@TS të raport-kontrollit.

Aktiviteti 2.2 Hartimi i Planeve sektoriale të përmbushjes në katër sektorë të evidentuar me risk

Lidhur me Planin Operacional të bar-kafe, AT po asistohet nga një projekt i Bankës Botërore "Insight behaviour", projekt i cili synon rritjen e përputhshmërisë së tatimpaguseve fillimisht nëpërmjet ndërgjegjesimit dhe më pas me analiza të thelluara dhe hetim të biznesve me qarkullim më të lartë në atë sektor. Ky model do të përdoret edhe në sektorë të tjerë të ekonomisë.

Masa 3: Shënjimi i sektorit të ndërtimit për vëmendje të hershme dhe analizimi i mundësisë të futjes së regjimit me "autofaturim" për të parandaluar humbjet tatimore në zinxhirin e furnizimit të nënkontraktorëve.

Synimi i kësaj mase është eliminimi i skemave të mashtrimit të TVSH në ndërtim duke sjellë një rritje të tvsh së pagueshme prej 0.12% e PPB ose 2.7 miliardë lekë. Ndërsa TVSH-ja e nëndeklaruar është e përhapur në të gjitha fushat e ekonomisë shqiptare, sektori i ndërtimeve dallon se është veçanërisht problematik. Përvoja ndërkombëtare është se ndërtimi është shumë i ndjeshëm ndaj mashtrimit të TVSH-së përgjatë zinxhirit të furnizimit të nënkontraktuesve. Duke e bërë marrësin e shërbimeve të ndërtimit në krye të zinxhirit (zakonisht kontraktori kryesor) përgjegjës për pagimin e TVSH-së, ajo mbron kundër nënkontraktuesve poshtë zinxhirit duke pretenduar të ngarkojë TVSH-në dhe më pas të zhduket. Regjimet e autofaturimit në ndërtim përdoren gjerësisht në BE dhe në mbarë botën. Në formulimin e strategjisë së tij afatmesme dhe planeve të veprimit, AT do t'i japë përparësi zhvillimit të një programi të përmirësimit të pajtueshmërisë, posaçërisht për sektorin e ndërtimit, për të zvogëluar humbjet e taksave në këtë sektor me rrezik të lartë.

Aktiviteti 3.1. Përgatitja e një analize të detajuar të fenomeneve të sektorit të ndërtimit dhe analizë e zinxhirit të TVSH- së së nënkontraktorëve duke paraqitur efektin në TVSH

Analiza do të përfshijë të gjithë tatimpaguesit që operojnë në sektorin e ndërtimit dhe nënkontraktorët e tyre duke filluar nga importi/prodhimi i lëndëve të para për sektorin e ndërtimit deri në analizën tek kantierët e ndërtimit.

Aktiviteti 3.2. Analiza e të dhënave dhe risqeve të sektorit të ndërtimit

Analiza do të përshijnë kuadrin ligjor në të cilin operon sektori i ndërtimit, bashkëndimi me institucione të tjera të tilla si AKBN në raste e ndërtimit të HEC apo me të dhënat e regjistrit të Lejeve të Ndërtimit nga Bashkitë.

Aktiviteti 3.3. Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve, prioritizimi i tyre, përcaktimi i shkaqeve të mospërbushjes në sektorin e ndërtimit

Aktiviteti 3.4. Finalizimi i planit sektorial të ndërtimit

Bazuar në analizat e mësipërme, AT do të hartojë një Plan Operacional i dedikuar vetëm për sektorin e ndërtimit.

Aktiviteti 3.5. Analiza e ndikimit të skemës së autofaturimit. Hartimi i një dokumenti analizes, për vlerësimin e përdorimit të skemave bazuar në eksperiencën e vendeve të tjera, duke reflektuar pro dhe kundër për secilën alternativë;

Aktiviteti 3.6. Hartimi i një propozimi ligjor për përdorimin e skemës së autofaturimit, ku marrësi i shërbimit të ndërtimit do të jetë përgjegjës për pagesën e TVSH-së së nënkontraktorëve.

Dy aktivitetet do të synojnë në hartimin e kuadrit ligjor për zbatimin e skemës së autofaturimit në sektorin e ndërtimit, vetëm për shërbimet. Mekanizmi i *autofaturimit* aplikohet gjërsisht në vendet e BE dhe vende të rajonit si Maqedonia e Veriut. Aplikimi i këtij mekanizmi shpang qarkullimin e pagesave të cilat lindin në lidhje me pagesat e copezuara dhe të cilat stimulojnë evazion dhe mashtrim të TVSH-së duke ia kaluar detyrimin për të qenë në pajtim me TVSH-në përfituesve të furnizimeve të cilët janë zakonisht më të lehte për t'u monitoruar dhe kontrolluar. Zbatimi i mekanizmit të autofaturimit eliminon kështu aplikimin e TVSH-së nga biznese të vogla dhe me rrisje më të mëdha në një zinxhir furnizimi, por në të njëjtën kohë i detyron bizneset e mëdha dhe më lehtësisht për t'u kontrolluar dhe monitoruar që të aplikojnë TVSH-në. Mekanizmi i autofaturimit në vetvete pakëson rrezikun e mashtrimit dhe evazionit.

Masa 4. Ngritja e masave shtesë mbrojtëse kundër mashtrimit në TVSH, përfshirë edhe përgjegjësinë “solidare dhe individuale” për TVSH-në dhe masat për autofaturim për mallra të caktuara që kanë më shumë gjasa të jenë pre e mashtrimit.

Synimi i kësaj mase është eliminimi i mundësive për mashtrim me TVSH edhe në sektorë të tjerë potencialë për mashtrim.

Një mekanizëm gjithnjë e më i zakonshëm për të parandaluar mashtrimin e TVSH-së është i ashtuquajti mekanizëm i përgjegjësisë "solidare dhe individuale" - kur një person tjetër përveç personit përgjegjës për pagesën e TVSH-së mund të konsiderohet përgjegjës - nëse ai e dinte ose duhej ta dinte se TVSH nuk do paguhej.

Aktiviteti 4.1. Identifikimi i nevojës për asistencë, kërkesa dhe analiza mbi kategorinë e mallrave apo sektorëve ku do mund të përdoret autofaturimi

Administrata tatimore do të bëjë një vlerësim të tërësisë së grupprodukteve më potenciale për mashtrim me TVSH-në.

Aktiviteti 4.2. Ndryshime të mundshme ligjore në ligjin “Për TVSH-në” .

Futja e mekanizmit të përgjegjësisë "të solidare dhe individuale" do të përshtatet në përputhje me parimet e përcaktuara në direktivën e BE-së për detyrime të përbashkëta dhe të TVSH-së, të cilat marrin parasysh nevojën për ruajtjen e ligjshme dhe siguri për palët me të vërtetë të pafajshme në një transaksion mashtrimi me TVSH.

Nëse nga analizat do të rezultojë nevoja që skema e autofaturimit të shtrihet edhe për mallra në sektorë specifikë, kjo do të përfshihet në ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Masa 5: Ngritja e Regjistrimit të Aseteve të tatimpaguesve (të luajtshme dhe të paluajtshme), me synimin e një vlerësimi real të pasurive të tatimpaguesit, duke ndërtuar një sistem për të verifikuar dhe gjurmuar të ardhurat e taksapaguesve, kontrollin e plotë të pagesave të bëra për taksat e pronës.

Aktiviteti 5.1 Krijimi i një Regjistri të Aseteve me atributet përkatëse;

Aktiviteti 5.2 Shkëmbimi i të dhënave me *ëeb-service*;

Aktiviteti 5.3 Analiza e të dhënave me Raportet *BI*.

Prioriteti II: Reduktimi i punës së padeklaruar dhe nëdeklarimit dhe ekonomisë kesh

Objektivi:

Ulja e punës së nëdeklaruar, rritja me 40 mijë punonjës në listegesa dhe ulja e qarkullimit të parasë kesh. Në tabelën 7 pasqyrohen të ardhurat në % të PBB nga prioriteti II. Këto të ardhura si % e PBB pasqyrohen në mënyrë kumulative.

	Objektivi	2022	2023	2024	2025	2026
Prioriteti II: Reduktimi i punës së padeklaruar dhe nëdeklarimit dhe ekonomisë cash	Ulja e punës së nëdeklaruar, rritja me 40 mijë punonjës që shtohen në listëpagesa dhe ulja e qarkullimit të parasë kesh	0.06%	0.08%	0.18%	0.22%	0.28%

Tabela 7 Prioritetit II - Rritja e të ardhurave në % të PBB-së

Stadi Aktual

Punësimi informal nënraportimi

Ka disa statistika dhe raportime mbi nivelin e lartë të punës në të zezë dhe nëdeklarimit të pagës në vend. Sipas Bankës Botërore, në vitin 2018 një ndër tre shqiptarë ekonomikisht aktivë ka punuar në një formë të punësimit informal - krahasuar me një në pesë në Serbi dhe Maqedoninë e Veriut. Një anketim i Southeast Europe Leadership for Development and Integrity (SELDI) mbi forcën punëtore në Shqipëri, në vitin 2016 zbuloi se 39 përqind e të anketuarve që morën pjesë, deklarorin se kishin punë të padeklaruar; 39 përqind nuk kishin kontratë me shkrim; 29 përqind deklarorin dhe paguarin kontribute sociale me pagën minimale; dhe 19 përqind marrin paga më të larta sesa në kontrata.

Ndërsa, një studim i Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) në vitin 2016 zbuloi se 31.9 përqind e punës jo-bujqësore ishte informale.

Ekonomia e madhe e parave kesh

Paratë kesh jashtë sistemit bankar në gusht 2019 ishin në nivele rekord (288 miliardë lekë ose 22 përqind e të gjitha parave që qarkullojnë) dhe ishin në trend rritës. Vlerësimet ekuivalente për Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë janë përkatësisht 7.4 përqind dhe 6.8 përqind.

Duke mbajtur nën fokus këto të dhëna dhe me synimin e uljes së tyre, janë parashikuar 11 masa që të ndërmerren në periudhë afatshkurtër dhe afatmesme për të adresuar këtë fenomen. Ndërmarrja e këtyre masave pritet të sjellë një rritje të të ardhurave tatimore me 6,55 miliardë lekë ose 0.28% të PBB-së.

Afatshkurta (2022-2023)

- ✓ **Masa 1: Hartimi i një qasjeje tërësore dhe të integruar në drejtim të mosdeklarimit të punonjësve.**
- ✓ **Masa 2: Përmirësimi i kuadrit bashkëpunues ndërinstitucional dhe sigurimi i planeve operacionale për të identifikuar punonjësit informalë, duke u mbështetur në një strategji të qartë.**
- ✓ **Masa 3: Analizimi i kategorive të personave të cilët kanë detyrimin të plotësojnë deklaratën individuale tatimit mbi të ardhurat personale.**

- ✓ **Masa 4: Fuqizimi i sanksioneve për veprat e lidhura me punonjësit e padeklaruar dhe nëndeklarimin.**
- ✓ **Masa 5: Përmirësimi i analizave dhe shkëmbimit të të dhënave për të shënjuar më mirë punonjësit e paregjistruar dhe nëndeklarimin.**
- ✓ **Masa 6: Fushatat e ndërgjegjësimit publik për të treguar përfitimet e punës së deklaruar dhe ekonomisë elektronike.**

Afatmesme (2024-2026)

- ✓ **Masa 7: Zbatimi i një plani masash për të ulur pagesat kesh në vend.**
- ✓ **Masa 8: Zhvillimi i partneriteteve më të ngushta me përfaqësuesit e biznesit dhe të komunitetit për t'i dhënë zgjidhje punës së padeklaruar, nëndeklarimit të pagës dhe konkurrencës së padrejtë në tatime.**

Rezultatet e Prioritetit

Rezultatet që priten të merren nga ky prioritet janë:

1. Trajtimi me përqsasje tërësore dhe integrale të problematikës së punësimit;
2. Kontrollë efektive tek bizneset informale bazuar në teknologjinë e informacionit;
3. Statistika të njëjta të fuqisë punëtore mes administratave;
4. Rritja e ndërgjegjësimit për pagesat e taksave;
5. Rritje e transaksioneve me para elektronike;
6. Rritja e marrëdhënieve kontraktuale punëdhënës dhe punëmarrës;
7. Rritja e transaksioneve elektronike;
8. Anketa të punëmarrësve lidhur me pagën, kontrata e punës;

Indikatorët:

- 1) Ulja e punësimit informal;
- 2) Ulja e nëndeklarimit të pagës reale;
- 3) Upgrade i sistemit për të parambushur DIVA;
- 4) Ulja e qarkullimit të parasë kesh;
- 5) Numri i kontrolleve të kryera nga analiza e kryqëzimit të të dhënave;
- 6) Përqindja e gjetjeve;
- 7) Numri i takimeve me grupet e biznesit;
- 8) Numri i terminaleve POS të instaluar tek bizneset;
- 9) Numri i kartave të debitit;
- 10) Ulja e perceptimit për informalitetin e punës.
- 11) Rritja e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale;
- 12) Rritja e të ardhurave nga kontributet;

Prioriteti II: Reduktimi i punës së padeklaruar dhe nëndeklarimit dhe ekonomisë cash				
Indikatorët:	Burimi i të dhënave	Baseline (2019)	Afatmesme	Objektivi (2024)
Ulja e punësimit informal	DPT	39% e të punësuarve informal (aktualisht janë 659186 të punësuar në listë pagesë Shtator 2019	Rritja me 40 mijë e të punësuarve në në zezë që formalizohen, per 5 vjet.	Rritja me 40 mijë e të punësuarve në në zezë që formalizohen

Ulja e nëndeklarimit të pagës reale	MFE	29% e të punësuarve nëndeklarajnë pagën reale	Rritja e deklarimit të pagës reale me 50 mijë punonjës , per 5 vjet, duke sjellë rritje me 0.53% të PPB të ardhura shtese TAP dhe kontribute	Rritja e deklarimit të pagës reale me 50 mijë punonjës duke sjellë rritje me 0.53% të PPB të ardhura shtese TAP dhe kontribute
Ulja e qarkullimit të parasë kesh	DPT	288 miliardë lekë ose 22 përqind e të gjitha parave që qarkullojnë	10% e gjithë parasë qarkullon kesh	10% e gjithë parasë qarkullon kesh
Numri i kontrolleve të kryera nga analiza e kryqëzimit të të dhënave	DPT			
Përqindja e gjetjeve	MFE			
Numri i takimeve me Grupet e biznesit për punësimin informal	MFE/DPT		6 takime vjetore	6 takime Vjetore
Numri i terminaleve POS të instaluar tek bizneset	Banka e Shqipërisë	11,195	Numri i njësive tregtare parësore dhe dytësore që do të përdorin терминалет POS mendohet të jetë rreth 130 mijë	Numri i njësive tregtare parësore dhe dytësore që do të përdorin терминалет POS mendohet të jetë rreth 130 mijë
Numri i kartave te debitit	MFE			
Ulja e perceptimit për informalitetin e punës	Sekretariati I KI	78% e biznesit perceptojnë se informaliteti është në të zezë	40% e biznesit perceptojnë se informaliteti vjen nga punësimi në të zezë	
Rritja e të ardhurave nga TAP	MFE	0.83% e PPB	0.87% e PPB	0.87% e PPB
Rritja e të ardhurave nga kontributet	MFE	3.62% e PPB	3.82% e PPB	3.82% e PPB

Tabela 8 Indikatorët e Prioritetit II

Të ardhurat nga politikat e ndërmarra në miliardë lekë

	2022	2023	2024	2025	2026
Prioriteti II Reduktimi i punës së padeklaruar dhe nëndeklarimit të ekonomisë cash	1,030	1,580	3,700	4,770	6,550
Rritja e numrit të të punësuarve në të zezë që formalizohen në 40 mijë punonjës për 5 vitet e ardhshme	840	1,180	3,100	3,900	5,350
Ulja e nëndeklarimit të pagës reale për 50.000 pozicione pune ose 7% të totalit të tyre në 5 vitet e ardhshme	190	400	600	870	1,200
Ndarë sipas Zërave					
Rritja e të ardhurave nga kontributet	980	1,480	3,560	4,590	6,320
Rritja e të ardhurave nga TAP	50	100	140	180	230

Tabela 9 Të ardhurat shtesë në vlerë nga ndërmarrja e masave të Prioritetit II

Në përqindje të PBB

	2022	2023	2024	2025	2026
Prioriteti II Reduktimi i punës së padeklaruar dhe nëndeklarimit të ekonomisë cash	0.06%	0.08%	0.18%	0.22%	0.28%
Rritja e numrit të të punësuarve në të zezë që formalizohen në 40 mijë punonjës për 5 vitet e ardhshme	0.05%	0.06%	0.15%	0.18%	0.23%
Ulja e nëndeklarimit të pagës reale për 50.000 pozicione pune ose 7% të totalit të tyre në 5 vitet e ardhshme	0.01%	0.02%	0.03%	0.04%	0.05%

Tabela 10 Të ardhurat shitesë në % të PBB-së të ndara në kategori nga ndërmarrja e masave të Prioriteti II

Masa 1. Hartimi i një qasjeje tërësore dhe të integruar në drejtim të mosdeklarimit të punonjësve.

Objektivi

Kalimi i punonjësve nga ekonomia informale tek punësimi formal është i vështirë. Përveç zbulimit dhe sanksioneve, do të ndiqen qasje politikanash të integruara, sipas **Figurës 2**.




Figure 2 Qasjet e politikave dhe masat për zbulimin e punës së padeklaruar¹

Bazuar në këtë përjasje, AT do të hartojë një Plan sektorial.

Aktiviteti 2.1.1.Hartimi i një Plani Sektorial për identifikimin e punës së padeklaruar.

¹Burimi: Regional Cooperation Council, Diagnostic Report on Undeclared Work in Albania, 2018

Hartimi i tërësisë së masave për adresimin e punës informale do të synojë në rritjen me 40 mijë e të punësuarve në të zezë të cilët formalizohen. Të ardhurat e rritura vlerësohen me 5.35 miliardë lekë shtesë ose 0.23% e PPB.

Masa 2. Përmirësimi i kuadrit bashkëpunues ndërinstitucional dhe sigurimi i planeve operacionale për të identifikuar punonjësit informale, duke u mbështetur në një strategji të qartë.

Institucione përgjegjëse për trajtimin e punës së padeklaruar janë: Administrata Tatimore (AT) në lidhje me tatimet dhe taksat, Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) në lidhje me kontributet shoqërore dhe Inspektoriati Shtetëror i Punës (ISHP) në lidhje me respektimin e Kodit të Punës. Këto institucione, duke qenë në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, kanë patur një koordinim më të mirë ndërinstitucional në nivelin operacional (të udhëhequr nga një komitet i të Ardhurave në MFE). Megjithatë, ekziston nevoja për një planifikim operacional më të organizuar (në vend të kontrolleve sporadike), bazuar në një strategji të qartë.

- ✓ Aktiviteti 2.1 Hartimi i një Pani Operacional Ndërinstitucional për bashkëpunimin dhe kontrollet mes AT, ISSH dhe ISHP.

Bashkëpunimi mes Administratës Tatimore dhe Inspektoriatit të Punës jo vetëm për kontrollet e përbashkëta për punësimet në të zezë, por edhe për nëndeklarimet e pagës reale, sidomos tek punonjësit të cilët punojnë me turne dhe për të cilat aplikohet një shtesë page mbi pagën bazë.

Masa 3: Analizimi i kategorive të personave të cilët kanë detyrimin të plotësojnë deklaratën individuale tatimit mbi të ardhurat personale.

Ndryshimet ligjore të ndërmarra gjatë vitit 2019, ku pjesë e kategorisë së individëve të cilat kishin detyrimin për plotësimin e Deklaratës individuale vjetore mbi të ardhurat u përfshinë edhe kategoria e individëve të punësuar në më shumë se një punëmarrës, ndikoi në rritjen e numrit të deklaratave të plotësuara nga 13,553 për deklaratat e vitit 2019, në 57,265 për deklaratat e vitit 2020. Në vitet pasuese, do të ndërmerren analiza të mëtejshme si për zgjerimin e kategorive të cilat do duhet të plotësojnë DIVA, si dhe do të ndërmerren hapa të mëtejshëm për ndëregjykimin e tatimpaguesve në lidhje me plotësimin e kësaj deklaratë.

Masa 4: Fuqizimi i sanksioneve për veprat e lidhura me punonjësit e padeklaruar dhe nëndeklarimin.

- ✓ Aktiviteti 4.1. Hartimi i propozimeve ligjore për ashpërsim të sanksioneve lidhur me punonjësit e padeklaruar dhe nëndeklarimin e pagës, në varësi të qarkullimi të biznesit, numrit të punonjësve dhe përsëritjes së shkeljeve ligjore.

Masa 5: Përmirësimi i analizave dhe shkëmbimit të të dhënave për të shënjuar më mirë punonjësit e pargjistruar dhe nëndeklarimin.

DPT do të ketë një përqendrim më të madh në identifikimin e njerëzve jashtë sistemit të taksave dhe kontributeve. Administrata Tatimore do të identifikojë grupimet më të larta të punës së mundshme informale midis statistikave të fuqisë punëtore, që tregojnë aktivitetin e vërtetë ekonomik dhe numrin e punëtorëve. Përputhja sistematike e të dhënave të palëve të treta është gjithashtu e nevojshme për të pasur efektivitet në identifikimin e taksapaguesve të pargjistruar. Grupimi i madh i të ardhurave të deklaruara në ose nën pagën minimale gjithashtu duhet të

hetohet duke përdorur teknika analitike. Në këtë drejtim, DPT do të ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

- ✓ Aktiviteti 5.1: Përcaktimi i mënyres së funksionimit të Drejtorisë së re të proceseve të Biznesit e cila do të ketë prioritarë pikërisht kryqëzimin e të dhënave;
- ✓ Aktiviteti 5.2: Marrja e informacioneve nga të gjitha planet sektoriale mbi të dhënat dhe analizat e kryera;
- ✓ Aktiviteti 5.3: Perzgjedhja e softëare-ve që mund të përdoren për analizimin e të dhënave.
- ✓ Aktiviteti 5.4. Organizimi i kontrolleve bazuar në perfundimet e dala nga kryqëzimi i të dhënave.

Masa 6. Fushatat e ndërgjegjësimit publik për të treguar përfitimet e punës së deklaruar dhe ekonomisë elektronike

Në bazë të një anketimi të Sekretariatit të Këshillit të Investimeve (KI) rezulton se 78% e bizneseve të anketuar perceptojnë se informaliteti vjen nga punësimi në të zezë. Përpos tërësisë së masave të mësipërme, do të organizohet një fushatë e gjerë kombëtare sensibilizuese mbi punësimin formal. Synimi i fushatës është që gradualisht do të ndihmojë në ndryshimin e vlerave, normave dhe besimeve në lidhje me përfitimet. Zhvillimi i një fushate të gjerë ndërgjegjësimi, duke garantuar konfidencialitetin e të dhënave të individit, e cila do të synojë inkurajimin e individëve që të shmangin operatorët me para në dore dhe të rrisi ndërgjegjësimin se raportimi i punës së pa deklaruar dhe nëndeklarimet e pagës, janë një përfitim jo vetëm për shtetin por mbi të gjitha për individin.

Gjithashtu, elementë të kësaj fushate do të jenë:

- Edukimi i tatimpaguesve në lidhje me rreziqet jo-tatimore të nëndeklarimit të të ardhurave, p.sh. pakësimi i pagesës së kontributeve të sigurimeve, qasje të kufizuar në kredi dhe aftësi e kufizuar për të shitur një biznes në të ardhmen.
- Marrja e informacionit të detajuar nga tatimpaguesit me qëllim rritjen e aftësive për të zbuluar dhe trajtuar aktivitetet e ekonomisë informale. Kjo ka për qëllim rritjen e besimit të komunitetit në efektivitetin e administratës duke demonstruar se shmangësit e taksave janë vënë para përgjegjësisë dhe do shërbejë si një pengesë e rëndësishme për të tjerët që mund të mendojnë të angazhohen në mosrespektimin e ligjit.
- Publikimi i masave/veprimeve kundër evazionit. Raportimi i rezultateve të arritura duke përfshirë ndjekjet penale të suksesshme që rrjedhin nga këto aktivitete.

Në mënyrë të përmbledhur, aktivitetet do të jenë:

- ✓ Aktiviteti 7.1: Hartimi i strategjisë
- ✓ Aktiviteti 7.2: Publikimi dhe mediatizimi i strategjisë

Masa 7. Zbatimi i një plani masash për të ulur pagesat cash në vend

Shqipëria ka një nivel shumë të lartë të parave që qarkullojnë jashtë sistemit bankar prej 22 përqind e të gjithë parave në qarkullim. Kjo sjell një ndikim të drejtpërdrejtë domethënës në të ardhurat e taksave dhe indirekt në rritjen ekonomike. Mbajtja e parasë fizike është e lidhur me disa faktorë:

1. Kultura jonë e kryerjes së pagesave me para në dorë;
2. Normë e ulët interesi për paranë;
3. Mosinstalimi i terminaleve POS në të gjitha pikat e shitjes me pakicë;

4. Burimi i parave kesh, nëse një individ ka një të ardhur 80 mijë lek në muaj dhe harxhon 200 mijë pra jashtë burimit të ligjshëm logjikisht që këtë diferencë e ka të krijuar nga burime të paligjshme.

Aktualisht pjesë e strategjisë 5 vjeçare do të jetë ulja e cash nëpërmjet përdorimit të terminaleve POS në Shqipëri. Vende të ndryshme të botës i kanë zbatuar me sukses këto eksperiencë. Greqia nga 1 Janar i vitit 2020, aplikon penalitetet tek individët nëse 1/3 e të ardhurave nuk e kanalizojnë nëpërmjet terminaleve POS.

Aktualisht, Shqipëria ka një nivel shumë të ulët të përdorimit të POS. Janë rreth 11,195 POS të instaluar nga tatimpaguesit, shifër kjo e papërfillshme duke marrë në konsideratë që në vend ushtrojnë aktivitet ekonomik mbi 110 mijë biznese. Lidhur me këtë do të vendoset detyrimi që gjithë bizneset të cilat ushtrojnë aktivitet të shitjes me para në dorë në sektorin e tregtisë, turizmit dhe shërbimeve do të kenë detyrimin që të instalojnë POS. Vlerësohet që numri i njësive tregtare parësore dhe dytësore që do të përdorin терминаlet POS të jetë rreth 130 mijë.

Ndërkohë numri i kartave të debitit të emetuara nga bankat e nivelit të dytë dhe të vlefshme/aktive aktualisht është 1,047,762 shifër kjo e mirë duke marrë në konsideratë se numri i të punësuarve në listëpagesat e DPT është mbi 650 mijë.

Bazuar dhe në eksperiencat e vendeve të tjera mbi masat e marra prej tyre për të ulur përdorim e pagesave cash në vend, SAA do të zbatojë masat e mëposhtme për të zhvendosur qarkullimin cash drejt pagesave elektronike. Kjo është në harmoni të plotë edhe me projektin e fiskalizimit.

- ✓ Aktiviteti 7.1. Vendosja e detyrimit të tatimpaguesve që zhvillojnë aktivitet në fushën e tregtisë, shërbimeve dhe turizmit që të instalojnë terminale POS;
- ✓ Aktiviteti 7.2. Detyrimi për t'u pajisur me kartë debiti të gjithë të punësuarit në vend dhe aplikim penaliteti në rast refuzimi;
- ✓ Aktiviteti 7.3. Krijimi i një grupi pune së bashku me Bankën e Shqipërisë dhe Shoqatën e Bankave për të ulur komisionet e përdorimit të terminaleve POS mes bankave të nivelit të dytë dhe tatimpaguesve si dhe ulja e kostos së mbajtjes së llogarisë bankare për individë dhe biznes të vogël;
- ✓ Aktiviteti 7.4. Ulja e pragut për pagesat me para në dorë mes bizneseve nga 150,000 lek që është aktualisht në 80,000 lek.

Masa 8: Zhvillimi i partneriteteve më të ngushta me përfaqësuesit e biznesit dhe të komunitetit për t'i dhënë zgjidhje punës së padeklaruar dhe konkurrencës së padrejtë në tatime.

Në këtë drejtim, DPT do të zhvillojë takime periodike me grupet e interesit (stakeholders) dhe kategori të ndryshme biznesi që janë identifikuar si problematike, në kuadër të punës së padeklaruar.

- ✓ Aktiviteti 11:1 Takime periodike 2 mujore me Grupet e biznesit për të diskutuar mbi faktorët e informalitetit në punësim.

Prioriteti III: Tatimi i çdo pasurie të pajustificuar brenda dhe jashtë vendit

Objektivi

Afatshkurtër (2022-2023)
<ul style="list-style-type: none">✓ Masa 1: Evidentimi i rasteve të pasurisë së madhe të pashpjeguar nga individët dhe dhënia e kompetencës ligjore inspektorëve të kontrollit për të nxjerrë vlerësim tatimor nëpërmjet metodave të tërthorta.✓ Masa 2: Evidentimi në veçanti i evazionit tatimor në lidhje me juridiksionet offshore bazuar në të dhënat e mbledhura si pasojë e shkëmbimit automatik të informacionit mbi llogaritë financiare sipas kuadrit të Standardit të Raportimit të Përbashkët (CRS).✓ Masa 3: Zgjerimi i programit të deklarimit vullnetar të parregullsive për të përfshirë fonde dhe pasuri të padeklaruara brenda vendit – përpara së cilës t'u kërkohet institucioneve financiare të bëjnë raportim automatik të informacioneve të llogarive të rezidentëve shqiptarë.✓ Masa 4: Të gjithë individët të cilët nuk marrin pjesë vullnetarisht tek Programi i Deklarimit Vullnetar do të jenë objekt i masave të forta hetuese nga struktura të specializuar të Hetimit Tatimor, e cila do të merret posacërisht me këtë kategori.✓ Masa 5: Krite të reja dhe të përmirësuara të riskut për identifikimin e tatimpaguesve që nuk përmbushin detyrimet tatimore
Afatmesme(2024-2026)
<ul style="list-style-type: none">✓ Masa 6: Mbledhja e taksave e shmangura nga korrupsioni dhe krimet e tjera financiare duke përmirësuar bashkëpunimin e "portave" midis agjencive të të ardhurave dhe organeve të tjera përmbartimore.✓ Masa 7: Ngritja e Regjistrimit të Aseteve të tatimpaguesve (të luajtshme dhe të paluajtshme), me synimin e një vlerësimi real të pasurive të tatimpaguesit, duke ndërtuar një sistem për të verifikuar dhe gjurmuar të ardhurat e taksapaguesve, kontrollin e plotë të pagesave të bëra për taksat e pronës.

Rezultatet e Prioritetit

Rezultatet që priten të merren nga ky prioritet janë:

1. Zbatimi i metodave indirekte të investigimit tatimor;
2. Shkëmbimi automatik i informacionit tatimor me administratat tatimore të huaja në kuadër të CRS;
3. Kapja dhe ndëshkimi i tatimpaguesve me pasuri jo të justifikueshme nëpërmjet bashkëpunimit me gjithë institucionet ligjzbatuese në vend;
4. Ulja e evazionit në juridiksionet offshore;
5. Rritja e deklarimit vullnetar të pasurive brenda dhe jashtë vendit;
6. Rritja e të ardhurave nga deklarimi vullnetar;
7. Ulja e evazionit tatimor nga paratë e padeklaruara në AT të mbajtura në institucione financiare;
8. Rritja e ndërgjegjësimit për vetdeklarim vullnetar;
9. Krijimi e një njësie të analizës së inteligjencës financiare.

Indikatorët:

1. Shkëmbimi automatik i informacionit tatimor me administrata tatimore të huaja;
2. Numri i pjesëmarrësve në DVP;
3. Të ardhurat e gjeneruara nga pjesëmarrja në DVP;
4. Investigime tatimore duke përdorur metodat indirekte;
5. Raste të investiguara të llogarive bankare brenda vendit të padeklaruar e justifikuar nga AT;
6. Raste të dyshuara nga Njësia e analizës dhe inteligjencës financiare dhe të gjetur me shkelje nga hetimi tatimor ose doganor;
7. Krijimi i Regjistrimit të Llogarive Bankare.

Masa 1: Evidentimi i rasteve të pasurisë së madhe të pashpjeguar nga individët dhe dhënia e kompetencës ligjore inspektorëve të kontrollit për të nxjerrë vlerësim tatimor nëpërmjet metodave të tërthorta.

Akumulimi i pasurive të pajustificuara - ku të ardhurat e deklaruara dhe burimet e fondeve janë qartësisht të pamjaftueshme për të financuar stilin e jetës dhe asetëve - është një faktor kryesor në minimizimin e besimit në sistemin e taksave. Aktualisht, inspektorët e DPT mund të vlerësojnë përgjegjësinë tatimore vetëm kur ka prova të drejtpërdrejta të evazionit nga librat dhe regjistrimet ose informacionet e palëve të treta - gjykatat nuk mbajnë vlerësime bazuar në prova indirekte të nën-deklarimit.

Për këtë arsye, ligji i procedurës tatimore duhet të ndryshohet për të lejuar në mënyrë të qartë metodat indirekte të auditimit dhe të sigurojë që vlerësimet e arsyeshme të bazuara në metoda të tilla janë të vlefshme, përveç nëse tatimpaguesi mund të shpjegojë burimet e akumulimit të pasurisë ose mospërputhjet e tjera.

Ligji për procedurat tatimore duhet ndryshuar për të mundësuar qartazi përdorimin e metodave të tërthorta të auditimit dhe për të përcaktuar se vlerësimet e arsyeshme të detyrimeve tatimore të mbështetura në metoda të tilla janë të vlefshme. Përgjashtime bëjnë rastet kur tatimpaguesit të mund të shpjegojnë burimin e akumulimit të pasurisë ose mospërputhje të tjera.

Gjithashtu, kjo do të shoqërohet me rekrutimin/përzgjedhjen e një numri të vogël punonjësish teknik për t'u trajnuar në mënyrë intensive për interpretimin e ligjit dhe metodat e tërthorta të kontrollit. Ky grup të marrë shpërblim vjetor dhe të bëjë deklaram vjetor të të ardhurave dhe pasurive, të ngjashme me atë që kërkohet nga drejtuesit e DPT-së. Ky grup të fokusohet në projektet me prioritetin më të lartë (p.sh., llogaritë bankare offshore dhe ndërtimi).

Për të zbatuar këtë rekomandim, DPT do të ndër marrë këto masa:

- ✓ Aktiviteti 1.1 Ndryshimi i ligjit të procedurave tatimore për të përfshirë metodat indirekte
- ✓ Aktiviteti 1.2 Trajnimimi i një grupi të caktuar inspektorësh me metodat indirekte të investigimit
- ✓ Aktiviteti 1.3 Takime me biznesin për ti informuar mbi aplikimin e metodave alternative;
- ✓ Aktiviteti 1.4 Përditesimi i Manualit të Kontrollit Tatimor, me një kapitull të veçantë për metodat indirekte;
- ✓ Aktiviteti 1.5 Analize e Hendekut Tatimore (Tax Gap). Kuptimi i arsyeve përse nuk janë përmbushës tatimpaguesit dhe hartimi i strategjive që adresojnë çështjet kryesore duke i ndihmuar tatimpaguesit të jenë përmbushës vullnetarë ose të shmangin mospërmbushjen.

Masa 2: Evidentimi në veçanti i evazionit tatimor në lidhje me juridiksionet offshore bazuar në të dhënat e mbledhura si pasojë e shkëmbimit automatik të informacionit mbi llogaritë financiare sipas kuadrit të Standardit të Raportimit të Përbashkët (CRS).

Një tipar ndërkomëbëtar i evazionit tatimor (zakonisht nga individë relativisht të pasur) është kalimi i shumave të parave në vende offshore. Në adresim të këtij fenomeni, OECD, ka bashkuar 150 juridiksione (Forumi Global) për t'u angazhuar në shkëmbimin automatik të informacionit për llogarinë financiare. Shqipëria filloi shkëmbimet e para automatike në dhjetor 2020 (me ndihmë teknike nga autoritetet tatimore italiane) dhe do të fillojë të marrë informacione për individë shqiptarë që kanë llogari financiare në juridiksionet e huaja (përfshirë këtu edhe pjesën më të madhe të "strehave" tradicionale offshore). Përvoja e vendeve që e kanë adaptuar më herët këtë masë, është që informacioni i shkëmbyer identifikon evazion të konsiderueshëm të taksave. Shqipëria nuk ka gjasa të jetë një përjashtim.

Gjithashtu, do të kryhen analiza periodike mbi rastet e evazionit në lidhje me juridiksionet offshore. Bazuar tek CRS, DPT ka hartuar një rregullore të brendshme që përcakton mënyrën e rrjedhjes së informacionit në DPT, si dhe mënyrën e monitorimit të bankave mbi zbatimin e verifikimit të duhur.

- ✓ Aktiviteti 2.1. Zbatimi i Projektit të Shkëmbimit Automatik të Informacionit;
- ✓ Aktiviteti 2.2 Analiza periodike mbi rastet e evazionit në lidhje me juridiksionet offshore;
- ✓ Aktiviteti 2.3. Zbatimi i rregullores së brendshme që përcakton mënyrën e rrjedhjes së informacionit në DPT si dhe monitorimin e bankave mbi zbatimin e verifikimit të duhur.

Masa 3: Të gjithë individët të cilët nuk marrin pjesë vullnetarisht tek Programi i Deklarimit Vullnetar do të jenë objekt i masave të forta hetuese nga struktura të specializuar të Hetimit Tatimor, e cila do të merret posaçërisht me këtë kategori.

Pas rishikimit të legjislacionit në fuqi dhe propozimit të ndryshimeve në kuadër të programit të deklarimit vullnetar të parregullsisë lidhur me juridiksionet offshore, DPT do të zbatojë një fushatë komunikimi me publikun. Në planin e komunikimit do të theksohen masat e forta që do të ndërmerren për ata që nuk do t'i përgjigjen programit të deklarimit vullnetar. Gjithashtu do të krijohet një njësi task force e dedikuar në investigimin e llogarive të individëve të marra nga administratat e huaja dhe nga llogaritë bankare institucionet brenda vendit.

- ✓ Aktiviteti 3.1. Organizimi i një fushate mediatike mbi DVP (shih III.3.2)
- ✓ Aktiviteti 3.2. Krijimi i një Task Force brenda hetimit tatimor

Masa 4: Mbledhja e taksave të shmangura nga korrupsioni dhe krimet e tjera financiare duke përmirësuar bashkëpunimin e "portave" midis agjencive të të ardhurave dhe organeve të tjera përmbarimore.

Administrata tatimore mund të jetë aktor kryesorë në luftën kundër krimit financiar dhe korrupsionit. Përvoja ndërkombëtare tregojnë që administratat fiskale ndihmojnë për të mbështetur dënimin penal dhe kjo përbën një element të fuqishëm në ndërtimin e besimit në institucionet shtetërore. Suksesi i kësaj qasje varet nga marrëveshjet e bashkëpunimit efektiv dhe të zbatuara mirë ndërmjet autoriteteve të të ardhurave dhe organeve të tjera të zbatimit të ligjit - prokurorisë, policisë, njësisë së inteligjencës financiare dhe autoriteteve antikorrupsion.

- 1) Aktiviteti 4.1: Hartimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi në fushën e investigimit financiar dhe korrupsioni midis MFE, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë.
- 2) Aktiviteti 4.2: Integrimi dhe përdorimi i të dhënave nga palët e treta (autoritetet kombëtare si Ujësjetësi, OSHEE, regjistrimi i automjeteve, bashkitë, etj.) në Data Warehouse të administratës tatimore.

[shqiptarja.com]

Prioriteti IV: Zvogëlimi i shmangies së taksave

Objektivi

Krijimi i instrumentave të duhur për të investiguar rastet e shmangieve tatimore.

Stadi Aktual

Evazioni i taksave në Shqipëri është qartë një kërcënim shumë më i madh sesa shmangia (d.m.th. marrëveshjet artificiale që kërkojnë të kapërcejnë qëllimin e ligjit). Sidoqoftë, ka një ekspozim të ndjeshëm ndaj humbjeve tatimore nga shmangiet që vijnë nga një kombinim i shumë "zonave gri" në ligjet tatimore; dobësi të dukshme të projektimit në elementët kryesorë të sistemit të taksave dhe mundësi nga kompanitë ndërkombëtare për të shfrytëzuar boshllëqet dhe mospërputhjet. Këto çështje duhet të adresohen për të ndaluar, ose të paktën që pakësojnë rrjedhje potencialisht të mëdha tatimore.

Tre janë masat kryesore që janë parashikuar të ndërmerren gjatë SAA.

Afatshkurtër (2022)
✓ Masa 1: Të sigurohet që rregulla e përgjithshme anti-abuzim (GAAR) të mund të zbatohet në mënyrë efektive dhe të veprjë si frenues për organizimet artificiale tatimore.
✓ Masa: Miratimi i masave shënjuese anti-evazion për të luftuar organizimet artificiale më të përhapura – vetëpunësimi "fiktiv" dhe ndarja artificiale e subjekteve.

Rezultatet e Prioritetit

Rezultatet që priten të merren nga ky prioritet janë:

1. Administrata tatimore ka kapacitetet njerëzore dhe instrumentat e duhur për të bërë investigime në fushën e antishmangies
2. Kryerja e investigimeve për raste të anti shmangies tatimore

Indikatorët:

- 1) Udhëzim mbi zbatimin e rregullave për antishmangien tatimore;
- 2) Staf i trajnuar mbi investigimet e shmangieve tatimore;
- 3) Plan veprimi për raste e vetpunësimit dhe ndarjes artificiale të biznesve;
- 4) Funkcionaliteti i njësisë speciale antievazion;
- 5) Raste të investiguara nga Njësia speciale;

Prioriteti IV: Zvogëlimi i shmangies artificiale të taksave				
Indikatorët:	Burimi i të dhënave	Baseline (2019)	Afatmesme	Objektivi (2026)
Udhëzim mbi zbatimin e rregullave për antishmangien tatimore	DPT	Nuk ka	Udhëzim detajues	Procedura të qarta investigimi
Staf i trajnuar mbi ivestigimet e shmangieve tatimore	DPT	Nuk ka	12 inspektorë të trajnuar	12 inspektorë të trajnuar
Plan veprimi për raste e vetpunësimit efekt dhe ndarjes artificiale të biznesve	DPT	Nuk ka		
Funksionaliteti i njësisë speciale antievazion	DPT	Nuk është krijuar	Krijuar	Krijuar

Raste të investiguara nga Njësia speciale	DPT	Nuk ka	Raste të investiguara	Raste të investiguara
---	-----	--------	-----------------------	-----------------------

Tabela 11 Indikatorët e Prioritetit IV

Masa 1: Të sigurohet që rregulla e përgjithshme anti-abuzim (GAAR) të mund të zbatohet në mënyrë efektive dhe të veprojë si frenues për organizimet artificiale tatimore.

GAAR i miratuar në vitin 2019 është një hap pozitiv, por aktualisht shprehet vetëm në terma shumë të gjerë. Komuniteti i biznesit, stafi i DPT dhe gjykatat që përfundimisht do t'i interpretojnë këto ligje - do të kenë nevojë për udhëzime më të qarta (përmes akteve nënligjore ose të tjera udhezime) se si funksionon ky ndryshim i rëndësishëm i ligjit; përndryshe do të jetë jo efektive. Për të adresuar këtë rekomandim, DPT do të hartojë një udhëzim të qartë ose Muanual për inspektorët tatimore për zbatimin e rregullave ekzistuese për anti-abuzimin dhe anti-shmangien.

- ✓ Aktiviteti 1.1: Hartimi i një Udhëzimi të qartë mbi zbatimin e rregullave ekzistuese për anti-abuzimin dhe anti-shmangien.
- ✓ Aktiviteti 1.2: Trajnime për stafin e administratës tatimore mbi rregullaat dhe kontrollet për anti shmangien

Masa 2: Hartimi i masave anti-evazion për të luftuar organizimet artificiale më të përhapura – vetëpunësimi “fiktiv” dhe ndarja artificiale e subjekteve.

DPT pas përcaktimit të dukurive kryesore dhe analizës mbi ndarjen artificiale të tatimpaguesve do të hartojë një plan veprimi në këtë drejtim.

Prioriteti V. Reduktimi i kostove të përmbushjes, rritja e sigurisë tatimore dhe besimit të administrata tatimore

Objektivi

Ulja e kostove të pajtueshmërisë dhe rritjen e sigurisë për tatimpaguesit

Stadi Aktual

Progres është arritur në uljen e kostove të pajtueshmërisë dhe rritjen e sigurisë për tatimpaguesit, e megjithatë dobësitë kryesore mbeten. Një ekuilibër i duhur midis shërbimit dhe zbatimit nga ana e administratës tatimore është thelbësor për përmirësimin e pajtueshmërisë së tatimpaguesit.

Afatshkurtër

- ✓ Masa 1: Hartimi i një strategjie për shërbimin e tatimpaguesve;
- ✓ Masa 2: Rimbursimi në kohë i Tvsh-së;
- ✓ Masa 3: Ngritja e një kuadri më të strukturuar për sigurimin e pacenueshmërisë së vlerave (integritetit);
- ✓ Masa 4: Dizenjimi i proceseve dhe produkteve tatimore në ndërveprim të rregullt me përdoruesit e shërbimeve të DPT, përfshirë ndërmjetësit kryesorë.

Rezultatet e Prioritetit

Rezultatet që priten të merren nga ky prioritet janë:

1. Ulje e kostove të pajtueshmërisë
2. Rritja e sigurisë për tatimpaguesit

Indikatorët:

- 1) Rritja e cilësisë së shërbimit të tatimpaguesve
- 2) Rritja e perceptimit të biznesit mbi cilësinë e shërbimit të tatimpaguesve
- 3) Rimbursimi në kohë i TVSH-së
- 4) Krijimi i një Forumi këshillues tek DPT me ekspertët kontabël, kontabistët e shoqatat e biznesit
- 5) Konsultimi i cdo procesi dhe produkti tatimor me përdoruesit e shërbimeve dhe ndërmjetësit

Prioriteti V. Reduktimi i kostove të përmbushjes dhe rritja e sigurisë tatimore dhe besimit të administrata tatimore				
Indikatorët	Burimi i të dhënave	Baseline (2019)	Afatmesme	Objektivi (2024)
Rritja e cilësisë së shërbimit të tatimpaguesve	DPT	<ul style="list-style-type: none">• 49% e bizneseve konstatojnë përmirësim në komunikimin me AT• 22% e biznesve të anketuara trajtohen nga AT• 72% e bizneseve kanë qartësi mbi	<ul style="list-style-type: none">• 65% e bizneseve konstatojnë përmirësim në komunikimin me AT• 50% e trajtohen nga AT• 85% e bizneseve kanë qartësi mbi informacionin tatimor	<ul style="list-style-type: none">• 80% e bizneseve konstatojnë përmirësim në komunikimin me AT• 75% e trajtohen nga AT• 95% e bizneseve kanë qartësi mbi informacionin tatimor

		informacionin tatimor		
Rritja e perceptimit të biznesit mbi cilësinë e shërbimit të tatimpaguesve	DPT	<ul style="list-style-type: none"> 20% e bizneseve të anketuara nuk vizitojnë sportelet e shërbimit, pasi përdorin shërbimet elektronike 	<ul style="list-style-type: none"> 45 % e bizneseve të anketuar nuk vizitojnë sportelet e shërbimit, pasi përdorin shërbimet elektronike 	<ul style="list-style-type: none"> 60 % e bizneseve të anketuar nuk vizitojnë sportelet e shërbimit, pasi përdorin shërbimet elektronike
Rimbursimi në kohë i TVSH-së	DPT	Afati mbi 90 ditë	Afati brenda 60 dite	Afati brenda 60 dite
	DPT	Në 78% të rasteve të raportuara gjatë 2019, TVSH e rimbursuar përfitohet pas ushtrimit të kontrollit tatimor	Vetëm 50 % e kërkesave me kontroll rimbursohen	30% e kërkesave me kontroll
Krijimi i një Forumi këshillues tek DPT me ekspertët kontabël, kontabistët e shoqatat e biznesit	MFE	Nuk ekziston	Krijohet	Krijohet
Konsultimi i cdo procesi dhe produkti tatimor me përdoruesit e shërbimeve dhe ndërmjetësit	MFE/DPT			

Tabela 12 Indikatorët e Prioritetit V

Masa 1: Hartimi i një strategjie për shërbimin e tatimpaguesve.

Pamvarësisht përmirësimeve pozitive të bërë ndër vite nga administrata tatimore në thjeshtimin e kostove të biznesit dhe rritjen e rolit këshillimues të saj, nuk ka një strategji gjithëpërfshirëse të AT për shërbimin ndaj tatimpaguesve.

Strategjia e cila do të realizohet brenda vitit 2022 do të përshkruajë vizionin e shërbimeve që DPT do të sigurojë për taksapaguesit dhe ndërmjetësuat. Kjo strategji duhet të jetë afatmesme dhe të përfshijë kanale që përcaktojnë se si do të ofrohen këto shërbime. Për të adresuar këtë rekomandim, DPT do të punojë drejt përmirësimit të udhëzimeve interpretuese për taksapaguesit dhe këshilltarët e tyre, si dhe përmirësimin e projektimit të produkteve dhe proceseve tatimore nëpërmjet ndërveprimit të rregullt dhe kuptimplotë me përdoruesit e shërbimeve të DPT-së, përfshirë edhe ndërmjetësit kryesorë.

- ✓ Aktiviteti 1.1. Përmirësimi i udhëzimeve interpretuese për subjektet tatimpaguese dhe këshilltarët e tyre.
- ✓ Aktiviteti 1.2. Përmirësimi i projektimit të produkteve dhe proceseve tatimore nëpërmjet ndërveprimit të rregullt dhe kuptimplotë me përdoruesit e shërbimeve të DPT-së, përfshirë edhe ndërmjetësit kyç.

Masa 2: Rimbursimi në kohë i TVSH-së

E rëndësishme në zbatimin e këtij prioriteti është rritja e besimit tek administrata tatimore në ndershmërinë e sistemit të taksave edhe nga vet administrata tatimore nëpërmjet rimbursimit në kohë të tvsh. Sipas një anketimi të bërë nga KI, ndër arsyt kryesore të mos-aplikimit për rimbursim të TVSH-së janë sipas radhës: mungesë besimi për përfitim (45%), procedurë e komplikuar në sistem (19%), dhe shumë dokumenta (16%). Rimbursimi TVSH-së përfitohet në masën 78% pas ushtrimit të kontrollit tatimor, e rritur si % krahasuar me një vit më parë; kjo ka sjellë rritje të numrit të ditëve për përfitim të Rimbursimit (TVSH rimbursuar në masë më të madhe përfitohet për një periudhë mbi 90 ditë, 56% krahasimisht më e lartë se një vit më parë).

Janë bërë hapa shumë pozitivë të rimbursimit të tvsh gjatë vitit 2021. Në fund të vitit 2021 stoku i TVSH-së ka qënë zero për të gjithë tatimpaguesit me metodën FIFO. Gjatë vitit 21 u dhanë si 11 muor rreth 22.3 miliard lekë rimbursim TVSH-je, shuma më e madhe se çdo vit tjetër. Gjatë vitit 2021 u miratua rregullorja e re e rimbursit që thjeshton mënyrën dhe afetet e rimbursimit të TVSH-se

Për të rritur besimin tek administrimi tatimor, zbatimin e afateve ligjore për rimbursimin në kohë të tvsh, administrata tatimore do të fokusohet në këto aktivitete

Ndryshim legjislativ për të rimbursuar kredinë e TVSH pa ndonjë periudhë minimale mbartëse dhe pa patur nevojë që tatimpaguesi të paraqesë një kërkesë të veçantë rimbursimi bazuar në një sistem online modern të aplikimit dhe trajtimit në kohë të kërkesave për rimbursim

Administrata tatimore është duke bashkëpunuar me AKSHI me qëllim që kërkesa për rimbursim të bëhen online nëpërmjet aplikimit në platformën e-albania nga fillimi i vitit 2022

Masa 3: Ngritja e një kuadri më të strukturuar për sigurimin e pacënueshmërisë së vlerave (integritetit).

Shkelja e integritetit nga ana e inspektorëve tatimore minon përpjekjet e DPT për të fituar besimin e tatimpaguesve në administrimin e sistemit të taksave - një ndikim kritik në nivelin e pajtueshmërisë vullnetare. DPT do të përfitonte nga zhvillimi i një kornize më gjithëpërfshirëse të sigurimit të integritetit që përcakton, komunikon dhe promovon standardet e sjelljes; monitoron dhe zbaton ato standarde, korrigjon gabimet; vlerëson dhe raporton mbi rezultatet e punës së cdo inspektori.

Në këtë drejtim, DPT do të rishikojë dhe përditësojë Kodin e Etikës aktuale të Administratës Tatimore dhe do të hartojë një strategji për të siguruar integritetin e punonjësve të saj.

- ✓ Aktiviteti 3.1. Rishikimi dhe përditesimi i kodit aktual të etikës që ka Administrata Tatimore
- ✓ Aktiviteti 3.2.: Rishikimi dhe hartimi i një strategjie mbi sigurimin e integritetit të punonjësve

Masa 4: Dizajnimi i proceseve dhe produkteve tatimore në ndërveprim të rregullt me përdoruesit e shërbimeve të DPT, përfshirë ndërmjetësit kryesorë

Ndërsa DPT angazhohet herë pas here me tatimpaguesit apo ekspertët fiskalë apo kontabilistët, nuk ka një forum të rregullt me këta aktorë. Këshilli Tatimor është forum, i cili përfshin DPT dhe përfaqësues të komunitetit të biznesit, por ky Këshill është i fokusuar të ofrojë konsultime dhe këshillime për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për çështjet e politikës tatimore në lidhje me paketat fiskale.

Përfshirja në diskutime dhe angazhimi i tatimpaguesve, kontabilistëve dhe ekspertëve fiskalë në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore tatimore, formularëve, procedurave dhe sistemeve të deklarimit, do të ndihmojë në thjeshtimin e sistemit tatimor dhe uljen e kostove të përmbushjes së detyrimeve tatimore.

- ✓ Aktiviteti 4.1. Krijimi i një Forum Këshillimor pranë DPT me ekspertë fiskalë, kontabilistë dhe përfaqësues të shoqatave profesionale për dizënjimin e proceseve dhe produkteve tatimore.

[shqiptarja.com]

Prioriteti VI. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga AT nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve institucionale të administratës tatimore

Forcimi dhe modernizimi i agjencive të administrimit të të ardhurave është thelbësor për mbledhjen efektive të të ardhurave. Ndërkohë që përfshirja e masave të reja të politikës së të ardhurave mund çojë në rritje të tyre, pjesa më e madhe varet nga efikasiteti i administratës bazuar në parimet e një Administrate Tatimore Efektive.

Janë ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm për të përmirësuar efektivitetin e DPT vitet e fundit. Tani DPT ka një sistem modern të IT-së, bashkëveprimi elektronik me taksapaguesit është normë duke përfshirë regjistrimin elektronik të deklaratave tatimore; struktura e DPT është thjeshtuar, është krijuar një Qendër Kombëtare e Thirrjeve dhe është bërë një progres në zhvillimin e një qasjeje moderne të menaxhimit të rrezikut të pajtueshmërisë (CRM). Në partneritet me Institutin e Statistikave dhe Regjistrin Kombëtar të Biznesit, DPT ka ndërmarrë gjithashtu një rifreskim gjithëpërfshirës të kodeve të industrisë dhe të dhënave të tjera të tatimpaguesve të regjistruara në regjistrin e saj kombëtar të tatimpaguesve. Për më tepër, projekti i Fiskalizimit së shpejti do t'i sigurojë DPT-së të dhëna në kohë reale mbi shitjet me para në dorë (Prill 2020) dhe faturat elektronike (Korrik 2021).

